



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 5	2003	Shkurt
--------------	-------------	---------------

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8990 datë 23.1.2003	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis.....	135
Ligj nr. 8991 datë 23.1.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, ndryshuar me vendimin nr.2, datë 25.1.1999 të Gjykatës Kushtetuese dhe me ligjet nr. 8453, datë 4.2.1999; nr. 8501, datë 16.6.1999 dhe nr. 8682, datë 7.11.2000.....	152
Vendim i KM nr. 34, datë 16.1.2003	Për miratimin e rregullores së funksionimit të Zonës së lirë.....	159

L I G J
Nr. 8990, datë 23.1.2003

PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj synon të sigurojë:

- a) vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të projekteve ose veprimtarive që kërkojnë të zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis;
- b) një proces vlerësimi të hapur dhe të administruar me paanshmëri, nëpërmjet pjesëmarrjes së organeve qendrore e vendore, të publikut, të organizatave jofitimprurëse për mjedisin, të propozuesit të projektit dhe të personave fizikë dhe juridikë, të specializuar në këtë fushë.

Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat, procedurat, afatet, të drejtat dhe detyrat:

- a) për të identifikuar, saktësuar dhe vlerësuar ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të projektit ose veprimtarisë në mjedisin ku do të zbatohen;
- b) për të krahasuar përparësitë dhe mangësitë e një projekti, të propozuar në variante të tjera, të mundshme, që përmbajnë ndryshime:
 - në vendin ku do të zbatohet projekti;
 - në përmasat dhe kapacitetet e tij;
 - në teknologji;
 - në krahasimet me gjendjen e mjedisit, nëse nuk do të zbatohet projekti;
 - në përcaktimin e masave për të parandaluar dhe zbutur dëmtimet në mjedis;
- b) për të siguruar shqyrtim cilësor teknik, profesional, juridik dhe administrativ të kërkesës dhe të marrjes së vendimit nga organet përkatëse.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj, fjalët e mëposhtme kanë këto kuptime:

- 1. “Ndikimi mesatar i pranueshëm” është ndikimi negativ në mjedis, i cili mund të pakësohet, nuk është i grumbulluar dhe nuk shkakton dëmtim të përhapur të mjedisit.
- 2. “Ndikimi i rëndësishëm” është ndikimi në mjedis, i cili nuk pakësohet me lehtësi, grumbullohet dhe shkakton dëmtim të përhapur të mjedisit.
- 3. “Ndikimi i drejtpërdrejtë” është ndikimi i shkaktuar vetëm nga zbatimi i projektit të dhënë.
- 4. “Ndikimi i tërthortë” është ndikimi i grumbulluar kohë më parë ose i zhvendosur në distancë, por që mund të parashikohet.
- 5. “Projekti” është:
 - zbatimi i veprave të ndërtimit, instalimeve ose skemave;

b) ndërhyrja në mjedisin natyror dhe peizazh, duke përfshirë edhe shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe të pasurive minerare.

6. “Klasifikimi” është procesi i shqyrtimit të raportit të përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kategorizuar një projekt, sipas shtojcave 1 e 2 të këtij ligji.

7. “Propozuesi” është personi fizik dhe juridik, që kërkon miratimin e një projekti, plani, programi ose politike.

KREU II VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS

Neni 4

Projektet që i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis

1. Procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen të gjitha projektet dhe veprimtaritë, që jepen në shtojcat 1 dhe 2 të këtij ligji, përpara miratimit të tyre nga organet përkatëse.

2. Projektet dhe veprimtaritë i nënshtrohen dy niveleve të shqyrtimit për vlerësimin e këtij ndikimi:

procesit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis;

procesit të përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

3. Procesit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen projektet e shtojcës 1 dhe projektet e veprimtarisë që kërkojnë të zbatohen në një zonë të mbrojtur ose në mjedisin detar të Republikës së Shqipërisë.

4. Procesit të përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen projektet e shtojcës 2 dhe ndryshimet ose rikonstruksionet e projekteve të shtojcës 1.

5. Një projekt i shtojcës 2 do t'i nënshtrohet procesit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, vetëm kur agjencia rajonale e mjedisit ose Ministria e Mjedisit, bazuar në kriteret e shtojcës 3 të këtij ligji, gjykon se ai mund të ketë ndikim të rëndësishëm në mjedis.

Neni 5

Vlerësimi strategjik mjedisor

Vlerësimi strategjik mjedisor i nënshtrohen:

a) strategjitë e planet e veprimit për energjitikën, minierat, industrinë, transportin, bujqësinë, pyjet, për administrimin e burimeve natyrore dhe të pasurive minerale dhe për administrimin e mbeturinave;

b) planet kombëtare dhe rajonale të rregullimit të territorit për qendrat e zonat urbane dhe rurale, për zonat industriale, për zonën bregdetare, për zonat turistike, për zonat e mbrojtura dhe zonat me ndjeshmëri të lartë ndaj ndotjes dhe dëmtimit.

2. Organi shtetëror ose personi fizik ose juridik, që paraqet një propozim, sipas pikës 1 të këtij neni, harton raportin e vlerësimit strategjik mjedisor dhe kërkon vlerësimin e tij nga Ministri i Mjedisit, përpara miratimit nga organet përkatëse. Vlerësimi jepet me deklaratën mjedisore, e cila publikohet.

3. Procedurat, afatet dhe detyrimet e palëve në të gjitha fazat e procesit të vlerësimit strategjik mjedisor janë të njëjta si për projektet që kërkojnë proces të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

KREU III PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Neni 6

Kërkesa për miratim

1. Kërkesën për miratimin e projektit dhe të dokumentacionit shoqërues, propozuesi i paraqet në agjencinë rajonale të mjedisit të qarkut ku do të zbatohet projekti ose do të ushtrohet veprimtaria.

2. Kërkesa përmban emrin, adresën, statusin juridik të propozuesit dhe projektin që

propozohet për miratim.

Dokumentacioni shoqërues përmban:

- a) për projektet që jepen në shtojcën 1, raportin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) për projektet e shtojcës 2, raportin e përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

4. Ministri i Mjedisit përcakton listën e dokumenteve që shoqërojnë kërkesën, sipas llojit dhe natyrës së projekteve ose veprimtarive që do të ushtrohen.

Neni 7

Raportet e vlerësimit të ndikimit në mjedis

1. Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis është dokumenti bazë ku mbështetet procesi i vlerësimit mjedisor për projektin e propozuar.

2. Raportet hartohen nga persona fizikë e juridikë të licencuar, të zgjedhur, të kontraktuar dhe të shpërblyer nga propozuesi. Për vërtetësinë e të dhënave, të përfundimeve dhe rekomandimeve të raportit hartuesit mbajnë përgjegjësi, sipas ligjeve në fuqi.

3. Për hartimin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis përdoren edhe të dhëna nga organet publike, sipas kërkesave të ligjit nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

4. Me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave miraton metodologjinë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ku përcaktohen me hollësi metodikat dhe kërkesat për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe vlerësimit strategjik mjedisor.

Neni 8

Raporti i përmbledhur i vlerësimit të ndikimit në mjedis

Raporti i përmbledhur i vlerësimit të ndikimit në mjedis përmban:

- a) qëllimin e projektit;
- b) përshkrimin e tij të hollësishëm;
- c) të dhënat për mjedisin ekzistues të zonës ku zbatohet projekti dhe në afërsi të saj;
- ç) përshkrimin e hollësishëm të të gjitha instalimeve, që bëjnë pjesë në projekt ose që do të përdoren gjatë zbatimit të tij;
- d) planin e ndërtimit dhe afatet e zbatimit të tij;
- dh) përshkrimin e veprave inxhinierike, që ndërtohen ose zgjerohen dhe të veprave të domosdoshme për zbatimin e projektit;
- e) ndikimet e mundshme në mjedis dhe masat e propozuara për parandalimin dhe zbutjen e tyre;
- ë) programin e monitorimit të ndikimit në mjedis të projektit;
- f) përputhjen e projektit me planet e rregullimit të territorit dhe me planet e zhvillimit ekonomik të zonës ku do të zbatohet projekti;
- g) përmbledhjen e këshillimeve me organet e qeverisjes vendore, publikun e organizatat jofitimprurëse për mjedisin dhe të mendimeve të tyre;
- gj) masat rehabilituese, në rast ndotjeje dhe dëmtimi të mjedisit, si dhe koston e tyre;
- h) kopjen e licencës së personit fizik ose juridik, që ka përgatitur raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Neni 9

Raporti i thelluar i vlerësimit të ndikimit në mjedis

Raporti i thelluar i vlerësimit të ndikimit në mjedis, veç të dhënave të raportit të përmbledhur, përmban edhe:

- a) procedurën dhe arsyet e përzgjedhjes së vendit ku do të zbatohet projekti, përshkrimin, të paktën edhe të dy varianteve të tjera, për lokalizimin e projektit;
- b) masën e ndikimit të tij të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në mjedis;
- c) ndikimet e mundshme të varianteve në mjedis e shëndet;
- ç) rreziqet për aksidente me ndikim të rëndësishëm në shëndet e mjedis dhe masat për

parandalimin e tyre;

d) ndikimin ndërkufitar në mjedis, nëse ka;

dh) planin e masave me karakter teknik, për të parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis;

e) përshkrime të hollësishme për përdorimin e qëndrueshëm të energjisë, të burimeve natyrore e minerare;

ë) planin e bashkëbisedimeve të pritshme me organet e qeverisjes vendore, publikun e organizatat jofitimprurëse për mjedisin gjatë fazave të planifikimit, shqyrtimit dhe zbatimit të projektit.

Neni 10

Shqyrtimi fillestar

Agjencia rajonale e mjedisit, brenda 5 ditëve nga marrja në dorëzim e kërkesës, bën shqyrtimin fillestar të dokumentacionit dhe:

a) pranon për shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues, nëse janë respektuar kërkesat e neneve 8 dhe 9 të këtij ligji dhe kërkon të paktën 5 kopje në gjuhën shqipe të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis;

b) hedh poshtë kërkesën, nëse dokumentet nuk janë hartuar sipas kërkesave të neneve 8 deri në 11 dhe njofton me shkrim propozuesin për plotësimet e rregullimet që duhet t'u bëjë dokumenteve;

c) procedurat e shqyrtimit të kërkesës nuk fillojnë nëse propozuesi nuk dorëzon dokumentacionin e plotësuar ose të korrigjuar.

Neni 11

Klasifikimi i kërkesës

1. Agjencia rajonale e mjedisit, në bashkëpunim me propozuesin, brenda 5 ditëve nga data e marrjes në dorëzim të kërkesës, bën klasifikimin e projektit të propozuar, sipas shtojcave 1 dhe 2 dhe vendos nëse ai do t'i nënshtrohet procesit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

2. Kur propozuesi e ka përfshirë raportin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dokumentacionin e dorëzuar, klasifikimi vlerësohet i kryer.

Neni 12

Procesi i thelluar i vlerësimit të ndikimit në mjedis

1. Kur nga klasifikimi rezulton se projekti i nënshtrohet procesit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, agjencia rajonale e mjedisit i kërkon, me shkrim, propozuesit të paraqesë raportin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

2. Këtë vendim agjencia rajonale e mjedisit ua njofton Ministrisë së Mjedisit, organeve që japin licencat e ndërtimit dhe të veprimtarisë, si dhe organeve të qeverisjes vendore të zonës ku do të zbatohet projekti.

3. Ndaj vendimit të agjencisë rajonale të mjedisit, propozuesi mund të ankohet te Ministri i Mjedisit brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, i cili shpall vendimin përfundimtar brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

Neni 13

Ndryshimet në projekt

1. Kur propozuesi kërkon të bëjë ndryshime në projekt ose në mënyrën e zbatimit të tij, gjatë kohës që kërkesa ka hyrë në procedurat e shqyrtimit, ia paraqet ato, me shkrim, agjencisë rajonale të mjedisit, që ka pranuar kërkesën.

2. Agjencia rajonale e mjedisit ose Ministria e Mjedisit pranon ndryshimet e propozuara, kur ndryshimet në projekt ose në mënyrën e zbatimit të tij janë të qarta e të sakta dhe nëse ka mundësi reale për shqyrtimin e tyre. Në njoftimin e pranimi, propozuesit i bëhet e ditur edhe zgjatja e afateve të shqyrtimit për shkak të ndryshimeve.

3. Kur ndryshimet e propozuara janë të paqarta, agjencia rajonale e mjedisit ose Ministria e Mjedisit hedh poshtë, me shkrim, pranimin e ndryshimeve dhe i kërkon propozuesit t'i riparaqesë ato.

4. Kur ndryshimet e propozuara janë aq të thella sa përbëjnë një projekt të ri, agjencia rajonale e mjedisit ose Ministria e Mjedisit hedh poshtë, me shkrim, pranimin e ndryshimeve dhe i sugjeron propozuesit të nisë procedurat për vlerësimin e projektit të ri.

5. Ndaj mospranimit të ndryshimeve, propozuesi mund të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit.

Neni 14

Mendimi i agjencisë rajonale të mjedisit

1. Agjencia rajonale e mjedisit, pasi këqyr në vend të dhënat e paraqitura në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe në të gjitha dokumentet e tjera, këshillohet me organet e qeverisjes vendore, të zhvillimit urban dhe turistik dhe përgatit, me shkrim, mendimin e vet të argumentuar, për miratimin ose mospranimin e projektit, si dhe propozon kushtet që duhen vendosur në dokumentin e miratimit, të cilat i përcjell në Ministrinë e Mjedisit brenda 20 ditëve kalendarike nga pranimi i kërkesës për shqyrtim.

2. Përshkrimi i hollësishëm i detyrave të agjencisë rajonale të mjedisit në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Mjedisit.

Neni 15

Afatet

1. Afatet e procesit të shqyrtimit nisin me dorëzimin e kërkesës së propozuesit nga agjencia rajonale e mjedisit në Ministrinë e Mjedisit dhe përfundojnë me shpalljen e vendimit nga Ministri i Mjedisit.

2. Koha prej 20 ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës nga agjencia rajonale e mjedisit deri në dorëzimin e saj në Ministrinë e Mjedisit, është fazë përgatitore.

3. Për projektet që kërkojnë një proces vlerësimi të thelluar, shqyrtimi bëhet brenda 3 muajve nga data që agjencia rajonale e mjedisit ka përcjellë kërkesën në Ministrinë e Mjedisit. Për projektet që kërkojnë një proces vlerësimi të përmblëdhur, shqyrtimi bëhet brenda 2 muajve.

4. Koha gjatë së cilës propozuesi bën ndërhyrjet për plotësim kërkesash, të dhënash, dokumentesh, shqyrtim ankimesh, zbritet nga afatet e detyrueshme për Ministrinë e Mjedisit.

Neni 16

Komisioni i shqyrtimit të kërkesave

1. Ministri i Mjedisit ngre komisionin e shqyrtimit të kërkesave, i cili propozon vendimet. Përbërja, detyrat dhe funksionimi i komisionit përcaktohen në rregulloren e tij, të miratuar nga Ministri i Mjedisit, duke synuar që në të të përfaqësohen të gjitha aspektet e mjedisit.

2. Nëse gjatë shqyrtimit vërehet se projekti, ndryshe nga klasifikimi i agjencisë rajonale të mjedisit, kërkon proces të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe kur dokumentacioni nuk përmban të dhënat e nevojshme, propozuesi detyrohet t'i paraqesë ato në Ministrinë e Mjedisit, për të vazhduar procedurën e shqyrtimit.

Neni 17

Kriteret e shqyrtimit

1. Shqyrtimi i kërkesës nga komisioni bëhet në bazë të kriterëve të shqyrtimit që kanë të bëjnë me:

verifikimin e shkallës së ndikimit në mjedis;

b) përputhshmërinë e projektit me planet kombëtare dhe rajonale të zhvillimit ekonomik e shoqëror dhe me planet e rregullimit të territorit;

c) mundësitë e propozuesit për të përballuar kostot e rehabilitimit të mjedisit të ndotur dhe të dëmtuar nga veprimtaria e tij;

ç) aftësitë teknike e teknologjike të projektit për të zbatuar kërkesat për parandalimin e ndotjes dhe të dëmtimit të mjedisit;

marrjen parasysh të mendimeve të palëve të interesuara.

2. Mbledhja e komisionit për shqyrtimin e kërkesave është e hapur për publikun e interesuar, organizatat jofitimprurëse për mjedisin, propozuesin dhe mediat.

Neni 18 **Specialistët**

1. Ministri i Mjedisit, për të siguruar kapacitetet e nevojshme dhe nivel të lartë profesional në shqyrtimin e kërkesës, angazhon specialistë, persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të licencuar dhe me përvojë në fushën e parashikimit e të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

2. Specialistët përgatisin, me shkrim, mendimet e tyre, thirren në mbledhjet e komisionit dhe japin shpjegimet e kërkuara.

3. Specialisti që ka marrë pjesë në hartimin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis të projektit, nuk mund të thirret për shqyrtimin e atij projekti.

4. Specialistët, për punën që bëjnë, shpërblehen sipas rregullave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe të Ministrit të Financave.

Neni 19 **Këshillimi me palët e interesuara**

Ministri i Mjedisit kërkon mendim nëse projekti është në përputhje me programet e planet kombëtare e rajonale të zhvillimit dhe për shkallën e pritshme të ndikimit në mjedis, duke ua dërguar përshkrimin e projektit dhe raportin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis:

organeve qendrore, që mbulojnë fushën e objektit të projektit;

organeve të zhvillimit urban dhe turistik;

organeve të qeverisjes vendore të zonës ku do të zbatohet projekti;

ç) instituteve të specializuara për parashikimin e ndikimit në mjedis.

Neni 20 **Debati publik**

1. Projekti dhe raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis i nështrohen debatit publik, ku marrin pjesë përfaqësues të ministrisë që licencën projektin, të organeve të rregullimit të territorit dhe turizmit, të organeve të qeverisjes vendore, të instituteve të specializuara, të publikut të interesuar, të organizatave jofitimprurëse për mjedisin dhe propozuesi.

2. Debati organizohet dhe drejtohet nga organi i qeverisjes vendore, ku do të zbatohet projekti, i cili brenda 5 ditëve pas marrjes së kërkesës për këshillim nga Ministri i Mjedisit:

a) njofton publikun dhe organizatat jofitimprurëse për mjedisin dhe vë në dispozicion të tyre raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis për 1 muaj;

b) në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe propozuesin, cakton ditën e debatit, njofton pjesëmarrësit 10 ditë përpara dhe, brenda afatit njëmuajor, organizon debatin e hapur me të gjithë të interesuarit.

3. Nëse në përfundim të debatit palët pjesëmarrëse nuk dërgojnë mendimet e tyre në Ministrinë e Mjedisit, komisioni i shqyrtimit vazhdon procedurat.

Neni 21 **Rezultati i shqyrtimit**

1. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, përfshirë edhe atë të hartuar gjatë procesit të shqyrtimit, komisioni përgatit raportin përfundimtar.

2. Raporti përfundimtar përmban propozimin për miratimin e kërkesës së hartuar në formën e deklaratës ose të lejes mjedisore ose mospranimin e argumentuar të kërkesës.

Neni 22
Marrja e vendimit

1. Brenda 5 ditëve nga dorëzimi i raportit të komisionit, Ministri i Mjedisit merr vendimin përkatës duke shpallur deklaratën ose lejen mjedisore.

2. Deklarata mjedisore përmban:

- a) normat e shkarkimeve të ndotësve të pritshëm në ajër, ujë dhe tokë;
- b) masat e detyrueshme që mbështeten në teknikat më të mira të mundshme të ndërtimit dhe vënies në punë të projektit;
- c) masat e detyrueshme për mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës, biodiversitetit dhe për të penguar transferimin e ndotjes nga një përbërës i mjedisit te një tjetër;
- ç) kërkesat për monitorimin e shkarkimeve, duke përcaktuar metodikën e matjeve, frekuencën e tyre, procedurën e vlerësimit dhe publikimin e rezultateve;
- d) kushtet për kufizimin e ndotjes ndërkufitare mbi normat e lejuara;
- dh) masat shtesë për të mos tejkaluar normat e cilësisë së mjedisit;
- e) kërkesën për të raportuar dhe krahasuar ndikimet e parashikuara gjatë hartimit të raportit të ndikimit në mjedis, me efektet reale të zbatimit të projektit.

3. Kur në vendim hidhet poshtë kërkesa, deklarata mjedisore përmban argumentimin e plotë të mospranimit nga pikëpamja mjedisore, teknike, ligjore dhe administrative.

Propozuesi mund ta paraqesë kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues jo më parë se 1 vit nga data e mospranimit të saj.

Neni 23
Njoftimi dhe ankimi ndaj vendimit

1. Ministri i Mjedisit njofton vendimin e tij, i cili publikohet dhe një kopje e deklaratës ose e lejes mjedisore u dërgohet propozuesit, organeve shtetërore që licencojnë veprimtarinë dhe organeve të qeverisjes vendore të zonës ku do të zbatohet projekti.

2. Kundër vendimit propozuesi mund të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga publikimi i tij.

Neni 24
Respektimi i kushteve mjedisore

1. Kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në deklaratën mjedisore mbahen parasysh nga këshillat e rregullimit të territorit, duke u përfshirë në përmbajtjen e lejeve të ndërtimit.

2. Projektet dhe veprimtaritë që jepen në shtojcat 1 dhe 2 zbatohen vetëm në përputhje me kushtet e vendosura në deklaratën mjedisore, në lejen mjedisore dhe në lejen e ndërtimit.

3. Projektet e shtojcave 1 dhe 2 nuk licencohen nga organet përkatëse, nëse nuk u janë nënshtruar procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe për to nuk është miratuar deklarata mjedisore.

Neni 25
Anulimi

1. Ministri i Mjedisit anulon, në çdo kohë, deklaratën ose lejen mjedisore të miratuar prej tij, kur vërtetohet se ato i ka lëshuar mbi dokumente të falsifikuara. Anulimi publikohet dhe kopja e tij u dërgohet organit licencues, organit të qeverisjes vendore të zonës ku zbatohet projekti dhe propozuesit.

2. Projekti dhe veprimtaria, të cilave u është anuluar deklarata ose leja mjedisore, pezullohen nga Inspektorati i Mjedisit, në bashkëpunim me Policinë Ndërtimore, për jo më pak se 3 muaj deri në 1 vit, kohë brenda së cilës përgatiten dhe riparaqiten kërkesa dhe dokumentet për shqyrtim.

3. Nëse propozuesi nuk paraqit dokumente brenda kohës së caktuar, Inspektorati i Mjedisit, në bashkëpunim me Policinë Ndërtimore dhe inspektoratin e organit licencues, urdhëron mbylljen e përhershme të veprimtarisë. Urdhrat për pezullimin dhe mbylljen e përhershme të veprimtarisë publikohen dhe kopje të tyre u dërgohen organit të qeverisjes vendore të zonës ku zbatohet projekti dhe propozuesit.

4. Ndaj urdhrave për pezullimin ose për mbylljen e përhershme të veprimtarisë, propozuesi mund të ankohet te Ministri i Mjedisit brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit, i cili përgjigjet brenda 20 ditëve nga marrja e ankimit. Ndaj vendimit të Ministrit, propozuesi mund të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit.

Neni 26

Pjesëmarrja e publikut

1. Publiku i interesuar dhe organizatat jofitimprurëse për mjedisin marrin pjesë në të gjitha fazat e procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, përfshi dhe vendimmarrjen. Ministri i Mjedisit përcakton me aktnormativ të veçantë detyrat e organeve mjedisore, për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe të organizatave jofitimprurëse për mjedisin në këtë proces.

2. Kur publiku i interesuar dhe organizatat jofitimprurëse për mjedisin vërejnë parregullsi në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, i kërkojnë Ministrit të Mjedisit rishqyrtimin pjesor ose tërësor të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili përgjigjet brenda 20 ditëve nga marrja e kërkesës.

Neni 27

Komunikimi me propozuesin

Ministria e Mjedisit dhe agjencia rajonale e mjedisit mbajnë vazhdimisht në dijeni propozuesin, duke e njoftuar zyrtarisht për qëndrimet dhe veprimet që ndërmarrin gjatë gjithë procesit të shqyrtimit të kërkesës.

Neni 28

Tërheqja e kërkesës

1. Propozuesi mund ta tërheqë kërkesën që ka paraqitur për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një strategjie, plani veprimi, projekti ose veprimtarie, në çdo kohë e në çdo fazë të shqyrtimit të saj, duke njoftuar me shkrim agjencinë rajonale të mjedisit ku ka dorëzuar kërkesën.

2. Në këtë rast, Ministri i Mjedisit urdhëron ndërprerjen e shqyrtimit të kërkesës dhe arkivimin e të gjithë dokumentacionit të paraqitur e të hartuar gjatë shqyrtimit, i cili nuk i kthehet propozuesit. Propozuesi paguan shpenzimet që ka bërë Ministria e Mjedisit për shqyrtimin e kërkesës deri në çastin e tërheqjes së saj.

3. Kërkesa mund të riparaqitet për shqyrtim, por jo më parë se 1 vit nga data e tërheqjes.

Neni 29

Ruajtja e dokumentacionit

1. Ministria e Mjedisit ruan të gjithë dokumentacionin e procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, jo më pak se 15 vjet nga marrja e vendimit. Ruajtja dhe administrimi i tij bëhen sipas legjislacionit në fuqi.

2. Propozuesi, për nevojat e veta, mund të kërkojë kopje të dokumentacionit ose të pjesëve të tij, duke paraqitur kërkesë me shkrim në Ministrinë e Mjedisit, e cila e plotëson kërkesën brenda 15 ditëve nga marrja e saj. Për këtë shërbim propozuesi paguan tarifë, sipas rregullave të përcaktuara nga Ministri i Mjedisit.

3. Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtë të njihet me dokumentacionin e arkivuar të propozuesit, duke zbatuar kërkesat e udhëzimit për kërkimin dhe marrjen e të dhënave për dokumentet zyrtare, të miratuara nga Ministri i Mjedisit.

Neni 30

Përballimi i shpenzimeve

1. Shpenzimet e përgatitjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të diskutimit publik, të shqyrtimit dhe këshillimit, përballohen nga propozuesi.

2. Shpenzimet e bëra nga agjencia rajonale e mjedisit dhe Ministria e Mjedisit për shqyrtimin e kërkesës dhe marrjen e vendimit, vlerësohen si tarifë shërbimi. Vlera e kësaj tarife përfshin të gjitha shpenzimet administrative gjatë procesit të shqyrtimit dhe marrjes së vendimit dhe përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Mjedisit.

3. Propozuesi likuidon një të tretën e tarifës, kur dorëzon kërkesën për shqyrtim, dhe dy të tretat përpara shqyrtimit përfundimtar në komision. Kërkesa nuk merret në dorëzim nga agjencia rajonale e mjedisit dhe komisioni nuk fillon shqyrtimin nëse propozuesi nuk ka bërë pagesat.

4. Tarifa e paguar është e pakthyeshme, pavarësisht nga fakti nëse kërkesa miratohet ose jo me vendimin përfundimtar.

Neni 31

Kundërvajtjet administrative

1. Bërja e deklaratave, hartimi i dokumenteve ose dhënia e informacioneve të rreme me qëllim sigurimin e miratimit të kërkesës, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 mijë deri në 300 mijë lekë, sipas rëndësisë së kundërvajtjes.

2. Gjoka vendoset dhe ekzekutohet nga Inspektorati i Mjedisit. Kundër saj mund të bëhet ankim te Ministri i Mjedisit brenda 10 ditëve, i cili duhet t'i përgjigjet ankimit brenda 15 ditëve nga depozitimi.

3. Kundër vendimit të Ministrit të Mjedisit ose kur ky i fundit nuk përgjigjet brenda 15 ditëve, mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve në gjykatë.

4. Kur këto shkelje përbëjnë vepër penale, Ministria e Mjedisit bën kallëzimin për ndjekje penale.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 32

Detyrimi për zbatim

Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe në rastet kur personi fizik ose juridik kërkon të bëjë ndryshime të rëndësishme në projektet e miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 33

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 7 pika 4 dhe nenit 18 pika 4 të këtij ligji.

Ngarkohet Ministri i Mjedisit të nxjerrë urdhrat dhe udhëzimet në zbatim të nenit 6 pika 4, nenit 14 pika 2, nenit 16 pika 1, nenit 26 pika 1, nenit 29 pikat 2 dhe 3 dhe nenit 30 pika 2 të këtij ligji.

Neni 34

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3681, datë 10.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

Veprimtari që i nënshtrohen procesit të thelluar
të vlerësimit të ndikimit në mjedis

1. Rafineritë e naftës dhe gazit, lëngëzimi dhe përpunimi i qymyrit dhe rërave bituminoze, impiante për rigjenerimin e vajrave të përdorur më të lartë se 100 000 tonë/vit.
2. Termocentrale të prodhimit të energjisë dhe impiante të tjera të djegies me prodhim nxehtësie më të madhe se 50 MV.
3. Hidrocentrale.
4. Uzina të shkrirjes së mineraleve (duke përfshirë mineralet që përmbajnë squfur).
5. Kalcinimi dhe pjekja e mineraleve që përmbajnë elemente toksike si zhiva, arseniku dhe kadmiumi.
6. Uzinat për derdhjen e gizës dhe çelikut (bashkimi primar ose sekondar), duke përfshirë derdhjen e vazhdueshme.
7. Uzinat ose fonderitë për përpunimin e metaleve të hekurit:
 - uzina të petëzimit;
 - kovaçhëna me çekiç, energjia e të cilave i kalon 50 KJ për çekiç, ndërsa fuqia kalorifike e përdorur i kalon 20 MV;
 - aplikimi i veshjeve mbrojtëse me metal të përzier me një input që i kalon 1 ton të çelikut bruto në orë.
8. Fonderi të metaleve të hekurit me një kapacitet prodhimi që i kalon 100 tonë në ditë.
9. Fonderi ose uzina për:
 - prodhimin e metaleve me ngjyra dhe metaleve joferrike nga mineralet, koncentratet ose lëndët dytësore të proceseve metalurgjike, kimike, elektrolitike;
 - shkrirjen, përfshirë përzierjen e metaleve me ngjyrë, përfshirë produktet e rikuperuara (rafinimi, derdhja në fonderi etj.) me një kapacitet shkrirjeje që i kalon 1 ton në ditë për plumbin dhe kadmiumin ose 10 tonë në ditë për të gjitha metalet.
10. Uzina për trajtimet sipërfaqësore të metaleve dhe materialeve plastike, duke përdorur një proces elektrolitik ose kimik në të cilin vëllimi i vatëve të trajtimit i kalon 10 m³.
11. Prodhimi dhe përpunimi i aliazheve për metale joferrike që përmbajnë arsenik, zhivë dhe plumb me kapacitet më të lartë se 1000 tonë në vit.
12. Nxjerrja dhe përpunimi i qymyrit, linjitit dhe mineraleve bitumene me kapacitete më të larta se 50 000 tonë në vit.
13. Nxjerrja e naftës me kapacitete më të larta se 50000 tonë/vit.
14. Nxjerrja e gazit natyror për qëllime tregtimi, ku sasia e nxjerrë është më e lartë se 250 000 m³ ditë për gazin natyror.
15. Fabrika për prodhimin e çimentos në furra rrotulluese (pjekje e tharje) me një kapacitet prodhues që i kalon 300 tonë në ditë ose për prodhimin e gëlqeres në furra rrotulluese me një kapacitet prodhues që i kalon 30 tonë në ditë ose në furnalta të tjera me një kapacitet prodhues që i kalon 30 tonë në ditë.
16. Fabrika për prodhimin e qelqit, përfshirë fibrat e xhamit me një kapacitet shkrirjeje që i kalon 10 tonë në ditë.
17. Fonderi për shkrirjen e substancave minerale, përfshirë prodhimin e fibrave minerale me kapacitet shkrirës që i kalon 10 tonë në ditë.
18. Fabrika për prodhimin e prodhimeve qeramike me anë të zjarrit e në veçanti tjegulla, tulla, tulla refraktare ose porcelani, me një kapacitet prodhues që i kalon 30 tonë në ditë.
19. Nxjerrja e gurorëve dhe minierat e hapura të argjilave, ku sipërfaqja e vendit është më e lartë se 5 hektarë, ose nxjerrja e torfës, ku sipërfaqja e vendit është më e madhe se 50 hektarë.
20. Prodhimi i fibrave të kartonit mbi 100 000 m²/vit.
21. Prodhimi i mobiljeve me kapacitete mbi 10000 m³/vit lëndë e parë.
22. Vepra të integruara për prodhimin në shkallë industriale të substancave ose grupeve të substancave të listuara në paragrafët (a-g) me anë të proceseve kimike:
 - (a) Për prodhimin e kimikateve organike bazë të tilla si:
 - hidrokarbure të thjeshta (lineare ose ciklike, të ngopura ose të pangopura, alifatike ose aromatike);

- hidrokarbure që përmbajnë oksigjen të tilla si: alkoole, aldehide, ketone, acide karboksilike, etere, aceton, peroksido, rrëshirë;
 - hidrokarbure sulfurike;
 - hidrokarbure të azotit të tilla si amine, amide, përbërës të azotit, përbërës të nitrarit, nitrile, sianete, izocianate;
 - hidrokarbure që përmbajnë fosfor;
 - hidrokarbure halogjene;
 - përbërës organometalik;
 - materiale plastike bazë (polimere, fibra sintetike dhe fibra me bazë celuloze);
 - goma sintetike;
 - ngjyrosës dhe pigmente;
 - agjentë aktivë sipërfaqësorë dhe sipërfaqësues.
- (b) Për prodhimin e kimikateve inorganike bazë, të tilla si:
- gaze të tilla si amonjaku, klori ose klorur hidrogjeni, fluori ose fluor hidrogjeni, dioksidi i karbonit, përbërës të sqfurit, hidrogjeni, dioksidi i sqfurit, kloruri i karbonit;
 - acide të tilla si acidi i kromit, acidi hidrofluorik, acidi fosforik, acidi nitrik, acidi klorhidrik, acidi sulfurik, oleumi dhe acidi sulfuror;
 - bazat, të tilla si hidroksidi i amonit, hidroksidi i kaliumit, hidroksidi i natriumit;
 - kripëra të tilla si kloruri i amonit, kloratet e kaliumit, karbonati i kaliumit, karbonati i natriumit, perboratet, nitati i argjendit;
 - jo metalet, oksidet e metaleve ose komponime të tjera organike si karbiti i kalciumit, silicit, karburi i silicit.
- (c) Për prodhimin e plehërave me bazë fosfatike ose fosfatike azotike (plehëra të thjeshta ose të përbëra);
- (ç) Për prodhimin e produkteve me bazë bimore shëndetësore dhe të biocideve;
- (d) Impiantet që përdorin proceset kimike ose biologjike për prodhimin e produkteve me bazë farmaceutike, bojërave dhe pesticideve;
- (dh) Impiante kimike për prodhimin e lëndëve shpërthyes;
- (e) Impiantet kimike që prodhojnë shtesa ushqimore proteinike, fermente dhe substanca të tjera proteinike me rrugë kimike ose biologjike;
23. Impiante për djegie, rikuperim, trajtim kimik, ose groposje të mbeturinave të rrezikshme.
24. Impiante për djegien e mbeturinave urbane me kapacitet më të madh se 1 tonë/orë.
25. Fushat për depozitimin e mbeturinave jo të rrezikshme me kapacitet më të madh se 30 tonë/ditë.
26. Ndërtimi i linjave për trafikun hekurudhor në distancë të gjatë dhe për aeroporte me rrugë kalimi bazë më të madhe ose të barabartë me 2100 m.
27. Ndërtimi i një rruge të re me dy ose më shumë korsi, ose rirreshtimi ose zgjerimi i një rruge ekzistuese me dy ose më pak korsi kur do të sigurohen dy ose më shumë korsi, në të cilën kjo rrugë e re ose seksion i rreshtuar dhe/ose i zgjeruar i rrugës duhet të jetë 5 km ose më shumë në vazhdimësi.
28. Rrugët e kalimit të ujërave të brendshme dhe portet për trafikun e rrugëve të kalimit të ujërave të brendshme që lejon kalimin e anijeve me tonazh mbi 500 tonë.
29. Portet e tregtimit, molot për ngarkim-shkarkim të lidhura me tokën ose porte të jashtme (duke përfshirë molot hekurudhore), të cilat mund të marrin anije me tonazh më të madh se 1000 tonë.
30. Nxjerrja e ujërave nëntokësore ose skemat artificiale të ringarkimit të ujërave nëntokësore, ku vëllimi vjetor i ujit të tërhequr ose të rimbushur (ringarkuar) është i barabartë ose më i madh se 5 milionë m³.
31. Punime për transferimin e burimeve ujore nga basenet e lumenjve, ku transferimi synon të rrugëkalimet e shkurtuara parandaluese të ujërave dhe ku sasia e ujërave të transferuara është më e madhe se 100 milionë m³/vit.
32. Në të gjitha rastet, punimet për transferimin e burimeve ujore nga basenet e lumenjve ku rrjedha shumëvjeçare e basenit është më e madhe se 1000 milionë m³/vit dhe ku sasia e ujërave të transferuara është më e madhe se 5 për qind e kësaj rrjedhjeje. Në të dyja rastet përjashtohet transferimi i ujit të pijshëm me tubacione.
33. Digat dhe rezervuaret e tjera të projektuara për mbrojtjen ose depozitimin e ujit, ku një sasi

shtesë e ujit është më e madhe se 5 milionë m³.

34. Tubacionet për transportimin e produkteve të naftës ose kimikateve me diametër më të madh se 500 mm dhe një gjatësi më të madhe se 10 km.

35. Impiantet për rritjen intensive të shpendëve, derrave e bagëtive të imëta që kanë më shumë se:

- a) 10 000 shpendë;
- b) 500 derra;
- c) 1000 bagëti të imëta;

36. Ndërtimi i linjave elektrike të tensionit të lartë, me një voltazh minimumi 220 KV ose me një gjatësi më të madhe se 10 km;

37. Impiantet e trajtimit të shkarkimeve të lëngëta urbane me kapacitet më të madh se 150 000 ekuivalent banorë;

38. Impiante industriale për:

- a) prodhimi i pulpës nga lëndët drusore ose fibrave të tjera të ngjashme;
- b) prodhimi i letrës dhe kartonave me kapacitet prodhues më të madh se 50 tonë/ditë.

39. Depo për ruajtjen dhe depozitimin e naftës, produkteve të saj, produkteve kimike dhe petrokimike me kapacitet më të lartë ose të barabartë me 100 000 tonë.

40. Impiantet për trajtimin paraprak (operacione të tilla si larja, zbardhja, mercerizimi), ose ngjyrosjen e fibrave dhe tekstileve, ku kapaciteti i trajtimit është më i lartë se 10 tonë/ditë.

41. Fabrika për trajtimin e lëkurëve, ku kapaciteti i trajtimit është më i madh se 6 tonë të produktit të përfutur/ditë.

42. Trajtimi dhe përpunimi i synuar për prodhimin e produkteve ushqimore nga:

- lëndët e para me origjinë shtazore (e të tjera përveç qumështit) me kapacitet të prodhimit të produktit të gatshëm më të madh se 30 tonë/ditë;

- lëndët e para bimore me kapacitet të prodhimit të produktit të përfunduar më të madh se 250 tonë/ditë (vlera mesatare mbi bazë një të katërtën);

- trajtimi dhe përpunimi i qumështit, sasia e qumështit të përfutur që është më e madhe se 100 tonë/ditë (vlera mesatare mbi bazë vjetore);

- impiant për depozitimin ose riqarkullimin e mbeturinave të kafshëve dhe skeleteve të kafshëve, me kapacitet trajtimi më të madh se 10 tonë/ditë;

- impiant për trajtimin sipërfaqësor të substancave, objekteve ose produkteve që përdorin solvente organike në veçanti për veshje, printim, mbiveshje, çyndyrësim, kundër depërtimit të ujit, bojërave, pastrim ose ngjeshje me një kapacitet më të madh se 100 tonë/vit.

SHTOJCA 2

Veprimtari që i nënshtrohen procesit të përmbledhur
të vlerësimit të ndikimit në mjedis

1. Bujqësia, silvikultura dhe akuakultura:

a) Projekte për restaurimin e zonave rurale

b) Projekte për përdorimin e tokave jobujqësore ose zonave gjysmënatyrore për qëllime të bujqësisë intensive;

c) Projekte të menaxhimit të ujërave për nevoja bujqësore duke përfshirë projektet e vaditjes dhe drenazhimit të tokës;

ç) Pyllëzimi dhe shpyllëzimi për qëllimet e ndryshimit të destinacionit të përdorimit të tokës;

d) Fermat intensive të peshkimit.

2. Industria nxjerrëse:

(a) Gurore, miniera të hapura (kariere) dhe nxjerrje torfe (projekte që nuk përfshihen në shtojcën 1);

(b) Minierat nëntokësore;

(c) Nxjerrja e mineral - inerteve nga drenazhimi detar dhe lumor;

(ç) Shpimet e thella, në veçanti:

- shpimet gjeotermike;

- shpimet për furnizimet me ujë, duke përjashtuar shpimet për të kontrolluar qëndrueshmërinë e tokës;

(d) Objekte sipërfaqësore industriale për nxjerrjen e qymyrit, naftës, gazit natyror, si dhe rërës bituminoze.

3. Industria energjitike (projekte që nuk përfshihen në shtojcën 1):

(a) Impiantet industriale për prodhimin e energjisë elektrike, avullit dhe ujit të nxehtë;

(b) Impiante industriale për mbajtjen e gazit, avullit, ujit të nxehtë për transmetimin e energjisë elektrike me anë kabllorsh (projekte që nuk përfshihen në shtojcën 1);

(c) Ruajtja në sipërfaqe e gazit natyror;

(ç) Ruajtja nën tokë e gazeve të djegshme;

(d) Ruajtja në sipërfaqe e lëndëve të djegshme të lëngëta;

(dh) Briketimi industrial i qymyrit dhe i linjtit;

(e) Impiantet për prodhimin e energjisë hidro-elektrike.

4. Prodhimi dhe përpunimi i metaleve (që nuk përfshihen në shtojcën 1):

(a) Prodhimi i hekurit të kuq dhe çelikut me derdhje të vazhdueshme;

(b) Impiantet për përpunimin e metaleve të hekurit;

(c) Fonderi të metaleve të hekurit;

(ç) Shkrirjen, duke përfshirë përzierjen e metaleve me ngjyrë, përfshirë produktet e rikuperuara (rafinimi, derdhja në fonderi etj.);

(d) Impiantet për trajtimet sipërfaqësore të metaleve dhe materialeve plastike;

(dh) Prodhimi dhe montimi i automjeteve dhe prodhimi i motorëve për automjete;

(e) Molo;

(ë) Impiante për pjekjen dhe sinterimin e mineraleve metalike.

5. Industria minerare: (projekte që nuk bëjnë pjesë në shtojcën 1):

(a) Furrat e koksit (distilim i thatë i qymyrit);

(b) Fabrika për prodhimin e çimentos;

(c) Fabrika për prodhimin e qelqit dhe të fibrave të qelqit;

(ç) Fonderi për shkrirjen e substancave minerare që përfshin edhe fibrat minerare;

(d) Prodhimi i produkteve qeramike me anë të djegies, tjegulla çatie, tulla, tulla refraktare, tjegulla, veshje guri ose porcelani.

6. Industria kimike (projekte që nuk bëjnë pjesë në shtojcën 1):

(a) Trajtimi i produkteve të ndërmjetme dhe prodhimi i kimikateve;

(b) Prodhimi i pesticideve dhe produkteve farmaceutike, bojërave dhe varakut, elastomereve dhe peroksive;

(c) Objektet e magazinimit për qëllime tregtimi apo ruajtjeje për naftën, produktet e naftës dhe produktet kimike.

7. Industria ushqimore:

(a) Prodhimi i vajërave dhe yndyrave shtazore dhe bimore;

(b) Paketimi dhe ambalazhimi i produkteve bimore;

(c) Prodhimi i produkteve bulmetore;

(ç) Fermentimi i birrës;

(d) Prodhimi i shurupeve dhe ëmbëlsirave;

(dh) Fabrikat për peshkun dhe vajin e peshkut;

(e) Fabrikat e sheqerit.

8. Industria e lëkurëve, drurit dhe letrës:

(a) Fabrikat për prodhimin e letrës (për projekte që nuk bëjnë pjesë në shtojcën 1);

(b) Impiante për paratrajtimin (larja, zbardhja, mercerizimi) ose lyerja e fibrave dhe tekstileve;

(c) Impiante për trajtimin e lëkurëve dhe thundrave;

(ç) Impiante për përpunimin dhe prodhimin e celulozës.

9. Industria e gomës:

- Prodhimi dhe trajtimi i produkteve me bazë elastomeri.

10. Projektet e infrastrukturës:

(a) Projekte të zhvillimit industrial;

(b) Projekte të zhvillimit urban, duke përfshirë ndërtimin e qendrave të blerjes dhe parkimet e automjeteve;

- (c) Ndërtimi i hekurudhave, faciliteteve intermodale e transportit dhe terminaleve intermodale (projekte që nuk bëjnë pjesë në shtojcën 1);
- (ç) Ndërtimi i fushave për avionë (për projekte që nuk bëjnë pjesë në shtojcën 1);
- (d) Ndërtimi i rrugëve, porteve dhe instalimeve në porte, duke përfshirë edhe portet e peshkimit (projekte që nuk bëjnë pjesë në shtojcën 1);
- (dh) Ndërtimi i kanalizimeve ujore në tokë, që nuk përfshihen në shtojcën 1;
- (e) Damesat dhe instalime të tjera të projektuara për të mbajtur ujë ose për ta ruajtur atë për një kohë të gjatë (projekte që nuk përfshihen në shtojcën 1);
- (ë) Tramvajet, ashensorët dhe hekurudhat e nëndheshme, të përdorura vetëm ose kryesisht për pasagjerë;
- (f) Vaji dhe tubacionet e instalimit të gazit (projekte që nuk përfshihen në shtojcën 1);
- (g) Puna në bregdet kundër erozionit dhe punimet që do të ndryshojnë bregdetin gjatë ndërtimit, si për shembull, molot dhe punime të tjera mbrojtëse detare, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe rikonstruktimin e punimeve të tilla;
- (gj) Nxjerrja e ujërave nëntokësore dhe skemat e rimbushjes artificiale të ujërave nëntokësore që nuk përfshihen në shtojcën 1;
- (h) Puna për transferimin e burimeve ujore midis baseneve të lumenjve që nuk përfshihen në shtojcën 1.

11. Projekte të tjera:

- (a) rrugë permanente që përdoren për testimin dhe garat e mjeteve të motorizuara; instalimet për eliminimin e plehërave (projekte që nuk përfshihen në shtojcën 1);
- (b) impiante për trajtimin e ujërave të ndotura (projekte që nuk përfshihen në shtojcën 1);
- (c) instalimet për grumbullimin e plehërave (projekte që nuk përfshihen në shtojcën 1);
- (ç) depot për ruajtjen e mbeturinave të hekurit, duke përfshirë skeletet metalike të makinave të dala jashtë përdorimit;
- (d) instalimet për prodhimin e fibrave minerare artificiale;
- (dh) instalimet për rikuperimin ose shkatërrimin e substancave eksplozive;
- (e) vendet e depozitimit të mbetjeve industriale;
- (ë) vendet që përdoren për grumbullimin e kafshëve të ngordhura ose të padëshirueshme;
- (f) industri ushqimore që nuk bëjnë pjesë në shtojcën 1.

12. turizmi dhe koha e lirë:

- (a) teleferikët e skive, makina me kablllo dhe zhvillime të shoqëruara me këto lloj veprimtarish;
- (b) portet turistike;
- (c) fshatra turistike dhe komplekset e hoteleve jashtë zonave urbane dhe të zhvillimeve të shoqëruara me këto lloj veprimtarish;
- (ç) vende (zona) të karavaneve dhe kampeve;
- (d) parqet zbavitëse.

SHTOJCA 3

Kriteret e përzgjedhjes

1. Karakteristikat e projektit

Karakteristikat e projektit duhet të merren në konsideratë, veçanërisht këto që vijojnë:

- madhësia e projektit;
- ndikimi i kombinuar në mjedis me projekte ekzistuese dhe ose të ardhshme;
- përdorimi i burimeve natyrore;
- gjenerimi i mbeturinave;
- ndotja dhe shqetësimi;
- rreziku për aksidente, bazuar kryesisht në substancat dhe teknologjitë e përdorura.

2. Vendndodhja e zbatimit të projektit

Ndjeshmëria mjedisore e zonave gjeografike që mund të ndikohen nga projekti duhen marrë në konsideratë, veçanërisht në:

- përdorimi ekzistues i tokës;
- bollëku relativ, cilësia dhe kapaciteti rigjenerues i burimeve natyrore në zonë;

- kapaciteti absorbues i mjedisit natyror duke i kushtuar vëmendje të veçantë zonave të mëposhtme:

- (a) ligatinat;
- (b) zonat bregdetare;
- (c) zonat malore dhe pyjore;
- (ç) parqet dhe rezervatet natyrore;
- (d) zona veçanërisht të mbrojtura;
- (dh) zona në të cilat standardet e cilësisë në mjedise kombëtare dhe të BE-së janë tejkaluar;
- (e) zona me popullsi të dendur;
- (f) peisazhe me rëndësi kulturore, arkeologjike dhe historike.

3. Karakteristikat e ndikimit të mundshëm

Ndikimet e mundshme të projekteve duhen shqyrtuar në përputhje me kriteret 1 dhe 2, por duke u bazuar veçanërisht në:

- shtrirja e ndikimit (zona gjeografike dhe shtrirja në distancë e popullatës së ndikuar);
- natyra ndërkufitare e ndikimit;
- madhësia dhe kompleksiteti i ndikimit;
- gjasat e ushtrimit të ndikimit;
- zgjatja, shpeshtësia dhe kthyeshmëria e ndikimit.

L I G J

Nr. 8991, datë 23.1.2003

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8405, DATË 17.9.1998 “PËR URBANISTIKËN”, NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.2, DATË 25.1.1999 TË GJYKATËS KUSHTETUESE DHE ME LIGJET NR.8453, DATË 4.2.1999; NR.8501, DATË 16.6.1999 DHE NR.8682, DATË 7.11.2000

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, ndryshuar me vendimin nr.2, datë 25.1.1999 të Gjykatës Kushtetuese dhe me ligjet nr.8453, datë 4.2.1999; nr.8501, datë 16.6.1999 dhe nr.8682, datë 7.11.2000, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen shtesat si më poshtë:

Pas paragrafit të tretë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

““Plani strategjik” është një proces pjesëmarrjeje në zhvillim, i cili, nëpërmjet një plani afatmesëm, bashkërendon punën për arritjen e objektivave strategjike, të përcaktuar nga vendimmarrësit kryesorë të pushtetit vendor. Plani strategjik ndërthur aspektin fizik, atë financiar dhe institucional. Veprimi i tij është i orientuar drejt menaxhimit të qendrës së banuar si një e tërë ose, të paktën, të komponentëve të tij kryesorë: banimit, tokës, infrastrukturës, rigjenerimit të burimeve financiare, administrimit të përgjithshëm, duke synuar integrimin e tyre.”.

- Pas paragrafit të pestë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

““Plani i veprimit” është një proces pjesëmarrjeje në zhvillim, i cili, nëpërmjet një plani relativisht afatshkurtër, bashkërendon punën për aktivizimin e burimeve të vlefshme materiale, financiare, për të arritur objektiva të kufizuar në zona të përcaktuara.”.

- Paragrafi i tetë ndryshohet si më poshtë:

““Zona suburbane” është zona që shtrihet jashtë vijës kufizuese të ndërtimit të qytetit. Kufiri i kësaj zone shërben për të ruajtur e parapërgatitur territorin e zhvillimit perspektiv të qytetit.”.

Neni 2

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Organizatat e specializuara për urbanistikën, pranë njësive të qeverisjes vendore, janë:

- Këshilli i Rregullimit të Territorit, pranë këshillit të qarkut, bashkive dhe komunave (KRRT).
- Njësia e urbanistikës (drejtori, sektor ose zyrë), në qark, në bashki dhe komuna.”.

Neni 3

Në nenin 15, pas fjalës “Lushnja” shtohen fjalët “Kukës, Peshkopi, Laç”.

Neni 4

Në nenin 17, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Anëtarët e KRRT-së së bashkive dhe komunave janë:

- kryetari i bashkisë/komunës;
- përgjegjësi i zyrës së urbanistikës në bashki/komunë;
- përgjegjësi i zyrës juridike në bashki/komunë;
- përgjegjësi i infrastrukturës publike në bashki/komunë;
- dy përfaqësues nga këshilli bashkiak/komunal;
- dy specialistë (urbanistë/arkitektë/inxhinierë ndërtimi), të caktuar nga kryetari i bashkisë/komunës;
- dy specialistë (urbanistë/arkitektë/ inxhinierë ndërtimi), të caktuar nga këshilli bashkiak/komunal.

Për komunat të cilat nuk mund të krijojnë KRRT-në me përbërjen e mësipërme, kompetencat e saj mund t’i ushtrojnë KRRT-ja e qarkut.

Neni 5

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

Anëtarë të KRRT-së së qarkut janë:

- kryetari i këshillit të qarkut;
- drejtori i drejtorisë së urbanistikës në qark (sekretar i KRRT-së);
- drejtori i kadastrës në qark;
- kryetari i bashkisë qendër qarku dhe një specialist (urbanist/arkitekt/inxhinier ndërtimi), i propozuar nga bashkia qendër qarku;
- përgjegjësi i shërbimeve publike në qark;
- përgjegjësi i ateliesë së monumenteve të kulturës që mbulon qarkun;
- përfaqësuesi i agjencisë rajonale të mjedisit;
- përfaqësuesi i sektorit të rrugëve;
- një specialist i caktuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit;
- tre përfaqësues nga këshilli i qarkut;
- përfaqësuesi i bashkisë/komunës, për të cilën shqyrtohet dhënia e lejes përkatëse.
- një specialist (urbanist/arkitekt/inxhinier ndërtimi), i caktuar nga kryetari i qarkut;
- dy specialistë (urbanistë/arkitektë/inxhinierë ndërtimi), të caktuar nga këshilli i qarkut;

- një specialist (urbanist/arkitekt/inxhinier ndërtimi), i caktuar nga prefektura.”.

Neni 6

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

KRRT-ja në qark ka kompetencë të shqyrtojë dhe të miratojë:

a) detyrat e projektimit për studimet urbanistike, që shtrihen në territorin e më shumë se një bashkie/komune, miratimi i të cilave është kompetencë e KRRT-së së qarkut në territorin brenda juridiksionit të saj;

b) platformën për zhvillimin e konkurseve për studimet urbanistike në kompetencë të saj;

c) planin strategjik, planin rajonal, masterplanet, në përputhje me programet e zhvillimit;

ç) vijën kufizuese të ndërtimeve dhe zonën suburbane të qyteteve;

d) vijën kufizuese të ndërtimit të fshatrave;

dh) studimet urbanistike, sheshet dhe lejet e ndërtimit jashtë vijave kufizuese të fshatrave, në zbërthim dhe zbatim të masterplaneve.

2. KRRT-të në bashki ose komunë kanë kompetencë të shqyrtojnë e të miratojnë:

a) detyrat e projektimit, studimet urbanistike, miratimi i të cilave është kompetencë e KRRT-së së bashkisë/komunës, në territorin brenda juridiksionit të saj;

b) platformën për zhvillimin e konkurseve për studime urbanistike në kompetencë të saj;

c) planin e përgjithshëm rregullues të qytetit dhe fshatit, planet e veprimit dhe rregulloret urbanistike, në përputhje me programet e zhvillimit rajonal;

ç) vijën kufizuese të ndërtimeve dhe kufirin e zonës suburbane të qyteteve;

d) planet rregulluese të fshatrave dhe studimet e pjesshme urbanistike brenda tyre;

dh) studimet e pjesshme urbanistike, në zbërthim dhe zbatim të masterplaneve të miratuara;

e) sheshet, lejet e ndërtimit dhe projektin e zbatimit, në zbatim dhe zbërthim të studimeve urbanistike të miratuara.

Në zonat turistike veprohet në përputhje me nenin 70 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar. Materialet që shqyrton KRRT-ja e qarkut, bashkisë/komunës mbi bazën e studimeve bashkë me opinionin e ekspertit nga sekretaria teknike e KRRT-së, funksionin e së cilës e kryen përkatësisht njësia e urbanistikës në qark, bashki/komunë.

Materialet që kalojnë për kompetencë në KRRTSH duhet të dorëzohen në sekretarinë e saj teknike jo më vonë se 60 ditë pas miratimit të tyre nga KRRT-ja e qarkut ose bashkisë/komunës.”.

Neni 7

Në nenin 21 bëhen këto shtesa:

- Në fjalinë e katërt, pas fjalëve “e pushtetit lokal të interesuar” shtohen fjalët “e përfaqësues të njësive projektuese”.

Shtohet një paragraf si më poshtë:

“Në rastet kur përfaqësuesi i prefekturës ka vërejtje ligjore për vendimet e KRRT-së, prefekti ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e lejes nga këshilli vendor përkatës.”.

Neni 8

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 22

Seksioni i urbanistikës në qark ka këto kompetenca:

1. Përgatit materialet për studimet në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit territorial, në bashkëpunim me bashkitë dhe komunat përkatëse dhe i paraqet për shqyrtim në KRRT.

2. Bashkërendon punën për hartimin e detyrës së projektimit të planit rajonal, të planit të

përgjithshëm rregullues, të masterplaneve të zhvillimit territorial, të studimeve të pjesshme urbanistike, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, në juridiksionin e qarkut dhe i paraqet në KRRT.

3. Në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore që janë në juridiksionin e qarkut, harton, në përputhje me detyrën e projektimit, sipas pikës 2 të këtij neni, masterplanet e zhvillimit, planet e përgjithshme rregulluese, studimet e pjesshme urbanistike ose i porosit ato, në përputhje me ligjin, në institucionet projektuese, shtetërore ose private, të licencuara në fushën e studimeve urbanistike, në zbatim e zbërthim të planeve strategjike dhe të politikave rajonale të miratuara, pasi ka marrë më parë rekomandimin e KRRT-së.

4. Shqyrton dhe paraqet në KRRT studimet urbanistike, sheshet dhe lejet e ndërtimit jashtë vijave kufizuese të fshatrave, në zbërthim dhe zbatim të masterplaneve.

5. Propozon rregullore të urbanistikës për territore në juridiksionin e qarkut, në përputhje me ligjin, dhe ia paraqet për miratim KRRT-së.

6. Përgatit materialin për ndryshimet përkatëse, në studimet e miratuara, kur paraqiten kushte të reja.

7. Mban lidhje sistematike me sekretarinë teknike të KRRTRSH-së dhe me zyrat e urbanistikës në bashki e komuna.

8. Ndihmon dhe bashkërendon punën me zyrat e urbanistikës në bashki e komuna për problemet teknike në zbatim të këtij ligji.

9. Përgatit vendimet e KRRT-së, dokumentacionin teknik, bashkë me kushtet urbanistike, të miratuara nga KRRT-ja, sipas nenit 6 të këtij ligji. Pas miratimit, 2 kopje origjinale të materialit ia dorëzon kërkuarës ose bashkisë/komunës, në juridiksionin e së cilës ndodhet zona e studiuar, jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së vendimit të KRRT-së.

10. Kontrollon nëse lejet e miratuara nga bashkitë dhe komunat janë dhënë në përputhje me studimet e miratuara nga KRRT-të përkatëse dhe, në rast shkeljeje të këtyre studimeve, njofton këshillin e zgjedhur përkatës.

11. Mban aktet e kontrollit për lejet e miratuara nga KRRT-ja e qarkut, për këto faza të realizimit të punimeve: piktetimi i objektit, përfundimi i themeleve dhe përfundimi i karabinasë, si dhe arkivon dokumentacionin teknik të objektit dhe dokumente të tjera të tij.

Pas aktit të kolaudimit, nëse nuk janë evidentuar shkelje të vendimit, përgatit materialin për lejen e shfrytëzimit.

12. Mban kadastrën dhe statistikën urbane dhe, në bashkëpunim me zyrën përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, bën azhurnimin e planimetrisë së qyteteve, fshatrave dhe komunave, të cilat i arkivon çdo fund viti.

13. Dërgon, çdo 6 muaj, në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të dhëna statistikore për fushën e planifikimit të territorit.

14. Njofton, brenda 5 ditëve, organet e Policisë së Ndërtimit për marrjen e masave përkatëse, kur vëren shkelje të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit, që kanë të bëjnë me KTP-në dhe KTZ-në, ose shkelje të rregullave të sigurimit teknik.

Neni 9

Pas nenit 22 shtohet neni 22/1, si më poshtë:

“Neni 22/1

Njësia e urbanistikës në Bashkinë e Tiranës, në bashkitë e kategorisë I, bashkitë e tjera dhe komuna ka këto kompetenca:

1. Përgatit materialet për studimet në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit territorial brenda juridiksionit dhe i paraqet për shqyrtim në KRRT.

2. Drejton punën për projektimin e planit të përgjithshëm rregullues, të masterplaneve të zhvillimit territorial, të planeve të veprimit, të studimeve të pjesshme urbanistike. Përgatit dokumentacionin teknik dhe e paraqet në këshillin e bashkisë ose të komunës dhe në KRRT.

3. Harton ose porosit, në përputhje me ligjin, në institucionet projektuese, shtetërore ose private, të licencuara në fushën e studimeve urbanistike, planin e përgjithshëm rregullues, planet e

veprimet, rregulloret e urbanistikës për qytetet/komunat, masterplanet, studimet e pjesshme, pasi ka marrë më parë rekomandimin e KRRT-së dhe ia paraqet asaj për miratim.

4. Mban lidhje sistematike me sekretarinë teknike të KRRTSH-së.

5. Bashkërendon punën me zyrën e urbanistikës në qark.

6. Përgatit studimet urbanistike për sheshet e ndërtimit, për territore pronë shtetërore, me propozimin e këshillit të bashkisë/komunës dhe me miratimin e kryetarit të KRRT-së.

7. Shqyrton kërkesat për sheshe dhe leje ndërtimi të çdo objekti dhe dokumentacionin përkatës, në përputhje me planin e përgjithshëm rregullues dhe studimin e pjesshëm urbanistik të miratuar dhe i paraqet ato në këshillin teknik dhe në KRRT.

8. Shqyrton kërkesat për prishje objektesh dhe prerje drurësh dhe i paraqet në KRRT.

9. Përgatit vendimet e KRRT-së dhe dokumentacionin e nevojshëm teknik, bashkë me kushtet urbanistike, sipas studimeve të miratuara. Pas miratimit nga kryetari i KRRT-së, ia dorëzon kërkuessit jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së vendimit, pasi kërkuessi të ketë paguar sipas ligjit detyrimet ndaj shtetit.

10. Mban aktet e kontrollit për këto faza të realizimit të punimeve: për piketimin e objektit, përfundimin e themeleve dhe të karabinasë, si dhe arkivon dokumentacionin teknik të objektit dhe dokumentet e tjera.

Pas aktit të kolaudit, nëse nuk janë vënë re shkelje, përgatit për miratim në KRRT materialin për lejen e shfrytëzimit.

11. Mban kadastrën dhe statistikën urbane në bashkëpunim me zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, bën azhurnimin e planimetrisë së qytetit/komunës, të cilën e arkivon në çdo fund viti;

12. Dërgon, çdo 6 muaj, në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të dhëna statistikore për fushën e planifikimit të territorit;

13. Njofton, brenda 5 ditëve, organet e Policisë së Ndërtimit për marrjen e masave përkatëse, kur vëren shkelje të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit, që kanë të bëjnë me KTP-në, KTZ-në dhe shkelje të rregullave të sigurimit teknik. Për rastet kur gjatë akteve të kontrollit vëren shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit, njofton në mbledhjen më të afërt KRRT-në, e cila merr menjëherë në shqyrtim këto shkelje.

14. Përgatit, me propozimin e KRRT-së, materialin për ndryshimet përkatëse kur paraqiten kushte të reja.”.

Neni 10

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Njësia e urbanistikës (drejtori, sektor ose zyrë), në qark, në Bashkinë e Tiranës dhe në bashkitë e kategorisë I duhet të ketë strukturën tip, me këtë përbërje:

sekretarinë teknike të KRRT-së;

urbanistikën studimore-projektuese;

kadastrën urbane;

urbanistikën ligjore;

infrastrukturën inxhinierike dhe të vlerësimit të impaktit në mjedis;

kontrollin teknik të projekteve.

Numri i punonjësve të urbanistikës caktohet, përkatësisht, nga këshilli i qarkut dhe këshilli bashkiak, ku përfshihen specialistë urbanistë, arkitektë, inxhinierë infrastrukture, inxhinierë topografë dhe juristë.

Numri i punonjësve të drejtorisë së urbanistikës në Bashkinë e Tiranës caktohet nga këshilli bashkiak, ku përfshihen specialistë urbanistë, arkitektë, inxhinierë mjedisi, inxhinierë ndërtimi, inxhinierë infrastrukture, inxhinierë topografë, juristë dhe ambientalistë.

Njësia e urbanistikës (drejtori, sektor ose zyrë) në bashki dhe komuna duhet të ketë strukturën tip, ku përfshihen:

sekretaria teknike;

kadastra urbane;

urbanistika studimore;
infrastruktura inxhinierike dhe e vlerësimit të impaktit në mjedis;
urbanistika ligjore dhe e kontrollit teknik të projekteve.”.

Neni 11

Në nenin 25 bëhen këto shtesa:

- Pas fjalisë së parë shtohet fjalia si më poshtë:

“Këshilli teknik shqyrton dhe jep mendim për anën tekniko-ligjore, për materialet që paraqiten për shqyrtim në KRRT.”.

- Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf, si më poshtë:

“Anëtarët e këshillit teknik shpërblehen për punën e kryer. Masa e shpërblimit caktohet nga këshilli përkatës i qeverisjes vendore.”.

Neni 12

Në paragrafin e parë të nenit 39 bëhen këto ndryshime:

- Fjalët “në seksionin e urbanistikës në këshillin e rrethit” shfuqizohen.

- Fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Zyrat e urbanistikës, sipas përkatësisë, pasi bëjnë shqyrtimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe, kur ai është në përputhje me kërkesat ligjore, ndjekin procedurat për paraqitje dhe shqyrtim në KRRT-në përkatëse.”.

Neni 13

Në nenet e këtij ligji, përjashtuar nenet e ndryshuara më sipër, emërtimet e mëposhtme zëvendësohen si më poshtë:

“organet e pushtetit lokal” zëvendësohet me “organet e qeverisjes vendore”;

“këshilli i rrethit” zëvendësohet me “këshilli i qarkut”;

“kryetari i këshillit të rrethit” zëvendësohet me “kryetari i këshillit të qarkut”.

“KRRT-ja në rreth” zëvendësohet me “KRRT-ja e qarkut”.

Neni 14

Nenet 23, 26 dhe 27 shfuqizohen.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr. 3682, datë 10.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

V E N D I M **Nr. 34, datë 16.1.2003**

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË ZONËS SË LIRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 12 të ligjit nr. 8636, datë

6.7.2000 “Për zonat e lira”, i ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e rregullore së funksionimit të Zonës së lirë, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË ZONËS SË LIRË

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objektivat

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave të krijimit dhe funksionimit të Zonës së lirë, që i nënshtrohet dispozitave të ligjit nr. 8636, datë 6.7.2000 “Për zonat e lira” dhe Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë. Objektivat kryesore të kësaj rregulloreje janë:
 - a. zhvillimi, administrimi dhe drejtimi i Zonës së lirë;
 - b. mbikëqyrja dhe kontrolli i Zonës së lirë.
2. Në përputhje me qëllimin dhe objektivat e treguara, kjo rregullore mbulon:
 - a. procedurën e aplikimit dhe licencimit të zhvilluesit;
 - b. të drejtat dhe detyrimet e zhvilluesit;
 - c. procedurën e aplikimit dhe licencimit të përdoruesit;
 - d. të drejtat dhe detyrimet e përdoruesit;
 - e. dokumentet e hyrjes dhe qëndrimit në zonë;
 - f. funksionet e përfaqësuesve të Entit në zonë;
 - g. funksionimin e Këshillit Drejtues.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë rregullore:

1. Fjala “ligj” nënkupton ligjin “Për Zonat e lira”.
2. Shprehjet “Zonë e lirë”, “Zhvillues”, “Përdorues”, “Ent” dhe “Këshill Drejtues” kanë të njëjtin kuptim respektiv me atë të përcaktuar në ligj.
3. Shprehjet “Zonë doganore”, “Zyrë doganore”, “Autoritete doganore” dhe “Detyrime doganore” kanë të njëjtin kuptim respektiv me atë të përcaktuar në dispozitat e Kodit Doganor.

II. PROCEDURA E APLIKIMIT DHE LICENCIMIT TË ZHVILLUESIT

Neni 3

Aplikimi për licencë zhvilluesi

1. Çdo person fizik ose juridik vendas ose i huaj, ka të drejtë të aplikojë për licencë zhvilluesi në një Zonë të lirë, pranë Entit Kombëtar të Zonave të Lira në sektorin e procedurës.
2. Kërkesa duhet të bëhet me shkrim sipas formëkërkesave të përcaktuara dhe të shoqërohet me të gjitha dokumentet e kërkuara në këtë rregullore.
3. Kandidati zhvillues dhe Këshilli Drejtues, mund të lidhin paraprakisht aktmarrëveshje me kusht pezullues, të cilat mund të ndihmojnë në aspektet procedurale të krijimit dhe funksionimit të një Zone të lirë.

Neni 4

Dokumentet që duhet të paraqesë kandidati zhvillues

1. Të gjithë personat fizikë ose juridikë shqiptarë ose të huaj që aplikojnë për licencë zhvilluesi, duhet të paraqesin këto dokumente:

- a. aktin e themelimit të shoqërisë;
 - b. vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik ose fizik;
 - c. vendimin e emërimit të përfaqësuesit ligjor;
 - d. statutin e shoqërisë;
 - e. kodin tatimor dhe NIPT-in;
 - f. një kopje të licencës së aktivitetit për vitin në vazhdim;
 - g. bilancet e tre viteve të fundit, të vërtetuara nga eksperti kontabël, kur ka aktivitet jashtë Zonës së lirë. Në rastin kur kandidati zhvillues është një shoqëri e re e sapo krijuar nga persona fizikë, zotëruesi i paketës kontrolluese duhet të paraqesë deklarata tatimore të tri viteve të fundit. Në rast se krijuesit janë persona juridikë, zotëruesi i paketës kontrolluese duhet të paraqesë bilancet e tri viteve të fundit të veprimtarisë së tij;
 - h. profilin tekniko-ekonomik të shoqërisë dhe CV-të e drejtuesve kryesorë të saj;
 - i. në rastin e truallit ose pasurisë së paluajtshme private, dokumentet e pronësisë ose kontratën e qirasë për truallin ose pasurinë e paluajtshme, që do të shpallet Zonë e lirë;
 - j. biznesplanin e aktivitetit të shoqërisë si zhvillues i Zonës së lirë;
 - k. projektin e plotë ndërtimor për infrastrukturën e brendshme dhe mënyrën e lidhjes së saj me infrastrukturën e jashtme;
 - l. burimet e financimit të projektit dhe garancitë e paraqitura ndaj financuesit;
 - m. letërrekomandimin nga një bankë me veprimtari në tregun ndërkombëtar;
 - n. letrat e pjesëmarrjes ose të interesit të lëshuara nga përdorues të ndryshëm që mendojnë të investojnë në zonë;
 - o. vërtetimin e lëshuar nga regjistri tregtar, në të cilin vërtetohet se shoqëria nuk është në procedura likuidimi dhe për drejtuesit kryesorë të saj dëshmitë e penalitetit. (Këto vërtetime duhet të kenë datë lëshimi jo më përpara se 3 muaj nga data e paraqitjes pranë Entit).
2. Personat fizikë ose juridikë të huaj, që aplikojnë për licencë zhvilluesi, duhet të paraqesin dokumentet ekuivalente me ato të paragrafit 1 të këtij neni, pikat a, b, c, d, në vartësi të legjislacionit të vendit ku personi i huaj është regjistruar.
3. Kandidati zhvillues, me dorëzimin e dokumenteve të kërkuara, pajiset me deklaratën e pranimi. Asnjë aplikant nuk pajiset me këtë deklaratë, në qoftë se mungon qoftë edhe një nga dokumentet e mësipërme. Data e deklaratës së pranimi përcakton fillimin e afatit kohor të procedurës.
4. Të gjitha dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe, në origjinal ose të njehsuara me origjinalin.

Neni 5

Shpallja e Zonës së lirë dhe licencimi i zhvilluesit në truall privat

Kandidati zhvillues i nënshtrohet procedurës së mëposhtme sipas afateve kohore të përcaktuara në këtë rregullore:

1. Kandidati zhvillues duhet të aplikojë pranë Entit, duke plotësuar formëkërkesën nr.1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
2. Kandidati zhvillues duhet të dorëzojë të gjitha dokumentet e përmendura në nenin 4 të kësaj rregulloreje.
3. Këshilli Drejtues brenda 3 muajve, pasi ka bërë vlerësimet paraprake, i paraqet Kryeministrit propozimin për shpalljen e Zonës së lirë dhe për kandidatin zhvillues të saj.
4. Këshilli i Ministrave brenda 2 muajve miraton ose refuzon aplikimin për shpalljen e Zonës së lirë dhe për kandidatin zhvillues të saj.
5. Zhvilluesi pajiset me licencë nga Enti, brenda 15 ditëve të punueshme nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Shpallja e Zonës së lirë dhe licencimi i zhvilluesit në truall shtetëror

Në rastin e truallit shtetëror, kandidati i nënshtrohet procedurës së mëposhtme sipas afateve kohore të përcaktuara në këtë rregullore:

1. Këshilli Drejtues i propozon Kryeministrit shpalljen e Zonës së lirë.
2. Këshilli Drejtues nëpërmjet Entit, i kalon për miratim Këshillit të Ministrave procedurën e tenderimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së zhvilluesit.
3. Këshilli Drejtues, jo më vonë se dy muaj nga data e mbylljes së procedurës së tenderimit nëpërmjet Entit, i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave kandidatin zhvillues.
4. Këshilli i Ministrave brenda 2 muajve miraton ose refuzon aplikimin për licencë të kandidatit zhvillues.
5. Zhvilluesi pajiset me licencë nga Enti, brenda 15 ditëve të punueshme nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e zhvilluesit.

Neni 7

Dhënia e licencës

1. Forma dhe përmbajtja e licencës së zhvilluesit miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe lëshohet nga Enti.
2. Licenca duhet të përmbajë:
 - a. numrin e serisë;
 - b. emrin e zhvilluesit;
 - c. kufijtë e zonës;
 - d. aktivitetet kryesore që do të zhvillohen në zonë;
 - e. datën e lëshimit;
 - f. kohëzgjatjen e licencës.
3. Kushtet e licencës konsiderohen pjesë përbërëse e kësaj licence dhe i bashkëngjiten asaj.
4. Licenca nënshkruhet nga drejtori ekzekutiv dhe mban vulën e Entit.
5. Licenca hartohet në tri kopje dhe regjistrohet në regjistrin e licencave. Një kopje mbahet pranë arkivit të Entit, një i jepet zhvilluesit dhe tjetra depozitohet pranë Zyrës doganore të Zonës së lirë.
6. Pagesa për shqyrtimin e dokumenteve dhe për marrjen e licencës nga zhvilluesi aprovohet nga Ministria e Financave.

Neni 8

Zëvendësimi i licencës

1. Licenca mund të zëvendësohet vetëm në rastet kur ajo humbet ose dëmtohet në mënyrë të paqëllimshme. Për zëvendësimin e saj zhvilluesi duhet të bëjë kërkesë me shkrim, pranë Entit. Ai pajiset me dublikatë jo më vonë se 5 ditë të punueshme nga data e pranimin të kërkesës. Dublikata ruan të njëjtat kushte me ato të licencës që zëvendëson.
2. Këshilli i Ministrave, me kërkesë të subjekteve të interesuara, mund të ndryshojë objektin e licencës dhe kushtet që ai i gjykon të nevojshme. Kushtet specifikohen në kontratë.

III. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ZHVILLUESIT

Neni 9

Të drejtat e zhvilluesit

Zhvilluesi ka të gjitha të drejtat e parashikuara në ligj dhe në aktet e tjera nënligjore që rrjedhin prej tij. Të drejtat dhe detyrimet e tij ndaj përdoruesve nuk janë objekt i kësaj rregulloreje.

Neni 10
Detyrimet e zhvilluesit

Përveç detyrimeve të parashikuara në ligj, licencë dhe kontratë, zhvilluesi duhet të plotësojë edhe detyrimet e mëposhtme:

1. Detyrimet e zhvilluesit në lidhje me ndërtimet në zonë:
 - a. ngritja e murit rrethues sipas perimetrit të zonës, në atë lartësi që është përcaktuar në standardet e vendosura nga strukturat përkatëse shtetërore, për të realizuar sigurimin dhe veçimin fizik të këtij territori nga pjesa tjetër e territorit doganor;
 - b. ndërtimi i portave të hyrjes dhe të daljes nga zona, të miratuara nga organet e parashikuara në ligj;
 - c. ndërtimi i shesheve dhe i të gjitha objekteve të tjera brenda zonës doganore të nevojshme për kontrollin dhe lëvizjen e mallrave, njerëzve dhe mjeteve të transportit;
 - d. ndërtimi i zyrave për përfaqësuesit e Entit, autoritetet doganore dhe për punonjësit e rendit, të cilat u jepen atyre në përdorim pa shpërbllim;
 - e. ndërtimi i infrastrukturës brenda zonës sipas projektit të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe lidhja e saj me infrastrukturën jashtë zonës;
 - f. siguri i mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe godinave të përmendura në pikën d, si dhe siguri i të gjitha kushteve normale të përdorimit të tyre.
2. Detyrimet e zhvilluesit në marrëdhëniet me organet e kontrollit shtetëror:
 - a. Zhvilluesi ka të gjitha detyrimet që i imponohen nga Kodi Doganor. Ai duhet të lejojë autoritetet doganore të bëjnë të gjitha kontrollet e nevojshme brenda Zonës së lirë, duhet të jetë i gatshëm të paraqesë sa herë që kërkohen nga autoritetet doganore, të gjitha dokumentet që ai disponon dhe të japë ndihmën e nevojshme për ekzaminimin fizik dhe dokumentor të mallrave në pronësi të përdoruesve.
 - b. Zhvilluesi duhet t'i japë përfaqësuesit të Entit të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me funksionimin e Zonës së lirë dhe të subjekteve brenda saj.
 - c. Zhvilluesi duhet të lejojë ushtrimin e funksioneve të organeve të rendit dhe të gjitha organeve të tjera të kontrollit shtetëror në zonë.
 - d. Zhvilluesi ka për detyrë të bashkëpunojë me përfaqësuesit e Entit, për të lëshuar të gjitha dokumentet e hyrjes dhe të qëndrimit në zonë.

IV. PROCEDURA E APLIKIMIT DHE LICENCIMIT TË PËRDORUESVE
NË ZONËN E LIRË

Neni 11
Kushtet e licencimit

1. Çdo person fizik ose juridik shqiptar ose i huaj, mund të aplikojë për licencim të parë si përdorues, pranë Entit Kombëtar të Zonave të Lira, në sektorin e procedurës. Kandidati përdorues në këtë rast duhet të paraqesë këto dokumente:
 - a. Formëkërkesën nr. 2;
 - b. Aktin e themelimit të shoqërisë që do të aplikojë;
 - c. Vendimin e gjykatës, për regjistrimin si person juridik ose fizik;
 - d. Vendimin e emërimit të përfaqësuesit ligjor;
 - e. Statutin e shoqërisë;
 - f. Kodin tatimor dhe NIPT-in;
 - g. Vërtetimin nga organet tatimore që nuk ka detyrime financiare ndaj shtetit, kur ka pasur aktivitet jashtë Zonës së lirë;
 - h. Aktmarrëveshje me kusht pezullues me zhvilluesin për t'i vënë në dispozicion përdoruesit sipërfaqe dhe objekte brenda zonës, kur kërkesa e tij për licencim të miratohet;
 - i. Numrin e regjistrimit në organet e sigurimeve shoqërore shtetërore;
 - j. Biznesplanin e aktivitetit brenda Zonës së lirë;
 - k. Rekomandim nga një bankë brenda ose jashtë vendit.
2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe, në origjinal ose të njehsuara me

origjinalin.

3. Në qoftë se nuk plotësohet qoftë edhe një nga kushtet e mësipërme kërkesa nuk merret në shqyrtim.

Neni 12

Rilicencimi dhe rinovimi i licencës

Çdo përdorues i licencuar ka të drejtë të ndjekë sipas rastit procedurën e rilicencimit ose rinovimit të licencës, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Rilicencimi

1. Çdo përdorues mund të aplikojë për rilicencim, kur ai ndryshon një nga elementet e mëposhtëm:

- a. llojin e aktiviteteve të specifikuar në licencë;
- b. emërtimin e shoqërisë tregtare;
- c. kohëzgjatjen e veprimtarisë së shoqërisë tregtare;
- d. formën juridike të shoqërisë tregtare.

2. Përdoruesit që kërkojnë të rilicencohen bëjnë kërkesë me shkrim pranë Entit Kombëtar të Zonave të lira, në sektorin e procedurës. Afati për miratimin ose refuzimin e kërkesës për rilicencimin është jo më shumë se 25 ditë të punëshme nga data e dorëzimit të kërkesës.

3. Përdoruesi që ndjek procedurën e rilicencimit duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

- a. Formëkërkesën nr.3;
- b. Licencën ekzistuese;
- c. Vendimin e gjykatës në lidhje me ndryshimet e bëra;
- d. Vërtetimin nga organet tatimore që nuk ka detyrime financiare ndaj shtetit.

4. Të gjitha dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe, në origjinal ose të njehsuara me origjinalin.

5. Në qoftë se nuk plotësohet qoftë edhe një nga kushtet e mësipërme kërkesa nuk merret në shqyrtim.

Neni 14

Rinovimi i licencës

1. Përdoruesi mund të aplikojë për rinovimin e licencës, kur kërkon të vazhdojë aktivitetin brenda Zonës së lirë përtej afateve të licencimit të parë. Për këtë ai duhet të bëjë kërkesë me shkrim pranë Entit Kombëtar të Zonave të lira, në sektorin e procedurës, të paktën 25 ditë të punëshme përpara datës së skadimit të licencës ekzistuese.

2. Përdoruesi që kërkon të rinovojë licencën duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

- a. Licencën ekzistuese;
- b. Formëkërkesën nr.4;
- c. Vërtetimin nga organet tatimore që nuk ka detyrime financiare ndaj shtetit;
- d. Aktmarrëveshjen me zhvilluesin për t'i vënë në dispozicion përdoruesit sipërfaqe dhe objekte brenda zonës, kur kërkesa e tij për rinovimin e licencës të miratohet.

3. Të gjitha dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe, në origjinal ose të njehsuara me origjinalin.

4. Në qoftë se nuk plotësohet qoftë edhe një nga kushtet e mësipërme, kërkesa nuk merret në shqyrtim.

Neni 15

Afatet dhe pagesat e licencave

1. Të gjitha licencat që janë përfituar nga procedura e licencimit të parë ose e rinovimit të licencës, kanë një afat prej jo më shumë se 30 vjet.

2. Të gjitha licencat me afat më të vogël se 30 vjet i jepen përdoruesit në këto raste:
a. Aplikon për rilicencim. Në këtë rast licenca e re jepet vetëm për afatin e mbetur nga licenca e mëparshme.

b. Afati i mbetur i veprimtarisë së shoqërisë sipas statutit ose afati i kontratës së qirasë ndërmjet zhvilluesit dhe përdoruesit është më i vogël se 30 vjet.

3. Pagesa për shqyrtimin e dokumenteve dhe për marrjen e licencës nga zhvilluesi aprovohet nga Ministria e Financave. Pagesa për shqyrtimin e dokumenteve bëhet në momentin e dorëzimit të tyre. Pagesa për licencën bëhet jo më vonë se 10 ditë të punëshme nga data e lëshimit të saj dhe është e vlefshme për të gjithë afatin e licencës.

Neni 16

Deklarata e pranimi

Çdo kandidat përdorues i një Zone të lirë, me dorëzimin e dokumenteve të mësipërme, pajiset me deklaratën e pranimi. Këshilli Drejtues miraton ose refuzon licencën e përdoruesit jo më vonë se 25 ditë të punëshme nga data e pajisjes së kandidatit me deklaratën e pranimi.

Neni 17

Regjistrimi i përdoruesve

Të gjithë përdoruesit e një zone të lirë regjistrohen në regjistrin e licencave pranë Entit Kombëtar të Zonave të Lira. Të dhënat e këtij regjistri i vihen në dispozicion përfaqësuesit të Entit në Zonën e lirë për të informuar organet tatimore, doganore dhe zhvilluesin.

Neni 18

Përmbajtja e licencës së përdoruesit

1. Forma dhe përmbajtja e licencës së përdoruesit miratohet nga Këshilli Drejtues. Licenca nënshkruhet nga drejtori ekzekutiv dhe mban vulën e Entit.

2. Licenca duhet të përmbajë:

- a. numrin e serisë;
- b. emrin e përdoruesit;
- c. aktivitetet që do të zhvillojë përdoruesi në zonë;
- d. datën e lëshimit;
- e. kohëzgjatjen e licencës.

3. Kushtet e licencës konsiderohen pjesë përbërëse e kësaj licence dhe i bashkëngjiten asaj.

4. Licenca hartohet në tri kopje dhe regjistrohet në regjistrin e licencave. Një kopje mbahet pranë arkivit të Entit, një i jepet përdoruesit dhe tjetra depozitohet pranë Zyrës doganore të Zonës së lirë.

Neni 19

Zëvendësimi i licencës

1. Licenca mund të zëvendësohet vetëm në rastet kur ajo humbet ose dëmtohet në mënyrë të paqëllimshme. Për zëvendësimin e saj përdoruesi duhet të bëjë kërkesë me shkrim pranë Entit. Ai pajiset me dublikatë jo më vonë se 5 ditë të punëshme nga data e pranimi të kërkesës. Dublikata ruan të njëjtat kushte me ato të licencës që zëvendëson.

2. Këshilli Drejtues me kërkesë të subjekteve të interesuara mund të ndryshojë objektin e licencës dhe kushtet bashkëngjitur asaj.

V. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PËRDORUESIT

Neni 20

Të drejtat e përdoruesit

Përdoruesi ka të gjitha të drejtat e parashikuara në ligj dhe aktet e tjera nënligjore që rrjedhin prej tij.

Neni 21

Detyrimet e përdoruesit

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tij në Zonën e lirë përdoruesi ka këto detyrime:

- a. Të lejojë ushtrimin e kontrollit nga organet doganore dhe tatimore mbi veprimtarinë e tij në zonë.
- b. Të lejojë organet e rendit dhe të gjitha organet e tjera të kontrollit shtetëror të ushtrojnë funksionet e tyre në zonë.
- c. Të pajisë përfaqësuesin e Entit me të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me veprimtarinë e tij në zonë.
- d. Të bashkëpunojë me përfaqësuesit e Entit për të informuar për pajisjen e punonjësve të tij me lejet e hyrjes dhe të qëndrimit në zonë, dhe të lejojë autoritetet doganore dhe ato të rendit për të ushtruar kontroll mbi to.
- e. Të zbatojë të gjitha detyrimet specifike të parashikuara në licencë dhe në kontratat e lidhura prej tij.

VI. DOKUMENTET E HYRJES DHE QËNDRIMIT NË ZONË

Neni 22

Lëshimi i dokumenteve të hyrjes dhe qëndrimit në zonë

1. Enti Kombëtar i Zonave të Lira nëpërmjet përfaqësuesit të tij në zonë, në bashkëpunim me Drejtorinë e doganave, pajis me lejet e hyrjes dhe qëndrimit, kartat e shërbimit dhe lejet speciale të gjithë personat që hyjnë në Zonën e lirë. Ndalohet hyrja në zonë e personave që nuk janë pajisur me lejet përkatëse.

- a. Pajisen me leje hyrje të gjithë punonjësit që punojnë pranë zhvilluesit dhe përdoruesit e një Zone të lirë.
- b. Pajisen me kartë shërbimi të gjithë nëpunësit shtetërorë të Entit Kombëtar të Zonave të Lira, Drejtorisë së doganave, Drejtorisë së tatimeve dhe punonjësit e rendit që punojnë pranë Zonës së lirë;
- c. Pajisen me leje speciale të gjithë ata persona që hyjnë në Zonën e lirë për detyra të përkohshme ose për të bashkëpunuar përkohësisht me autoritetet shtetërore, zhvilluesin dhe përdoruesin.

Neni 23

Përmbajtja dhe kohëzgjatja e dokumenteve

Leja e hyrjes është një vjeçare dhe përmban:

- emrin dhe mbiemrin e poseduesit të lejes,
- emrin e shoqërisë në të cilën ai është në marrëdhënie pune brenda zonës,
- profesionin,
- shtetësinë,
- numrin dhe serinë e dokumentit të identifikimit,
- fotografinë,
- afatin e përdorimit të lejes,
- firmën e përfaqësuesit të Entit dhe vulën e këtij institucioni.

2. Karta e shërbimit është një vjeçare dhe përmban:

- emrin dhe mbiemrin e poseduesit të kartës,
- institucionin në të cilin ai është i punësuar,
- profesionin,
- fotografinë,
- afatin e përdorimit të kartës,
- firmën e përfaqësuesit të Entit dhe vulën e këtij institucioni.

2. Pagesat për lejet e hyrjes dhe kartat e shërbimit përcaktohen nga Ministria e Financave.
3. Leja speciale lëshohet në këmbim të një dokumenti identifikimi, është një kalimshe me kohëzgjatje jo më shumë se një ditë pune dhe përmban:

- numrin e serisë,
- emrin e personit që do të hyjë në zonë,
- destinacionin brenda zonës,
- kohën e lëshimit,
- firmën e punonjësit që e lëshon.

Leja speciale lëshohet edhe për drejtuesit e automjeteve dhe në të përfshihen edhe të dhënat për automjetin. Përsa i përket mjeteve të transportit hekurudhor dhe detar, hyrja e tyre në zonë përcaktohet me udhëzime të veçanta.

Neni 24

Anulimi dhe zëvendësimi i lejeve të hyrjes dhe kartave të shërbimit

1. Leja e hyrjes do të anulohet në rastet e mëposhtme:
 - a. Kur poseduesi i saj ndërpret marrëdhëniet e punës me zhvilluesin ose përdoruesin. Në këtë rast zhvilluesi ose përdoruesi duhet të informojë përfaqësuesin e Entit Kombëtar të Zonave të Lira për të bërë anulimin e lejes.
 - b. Kur mbajtësi i saj gjykohet se ka shkelur dispozitat e Kodit Doganor, rregulloren e Zonës së lirë si dhe cenon rendin dhe qetësinë.
2. Karta e shërbimit do të anulohet, në rastin kur nëpunësi ndërpret marrëdhëniet e punës me institucionin përkatës. Në këtë rast institucioni duhet të informojë përfaqësuesin e Entit për të bërë anulimin e kartës.
3. Punonjësit e rendit kanë të drejtë të largojnë nga zona çdo person, leja e hyrjes ose karta e shërbimit të të cilit është anuluar. Në këto raste nëpunësit e doganës duhet të zbatojnë rregulloren e doganës për mallrat që posedon personi.
4. Leja e hyrjes dhe karta e shërbimit mund të zëvendësohen vetëm në rastet kur ato humbasin ose dëmtohen në mënyrë të paqëllimshme. Për zëvendësimin e tyre personi duhet të bëjë kërkesë me shkrim pranë autoriteteve përkatëse. Ai pajiset me dublikatë jo më vonë se 5 ditë të punëshme nga data e pranimit të kërkesës.
5. Ngarkohen organet e rendit të kontrollojnë dokumentet e hyrjes në zonë për të gjithë poseduesit e tyre.

Neni 25

Regjistrimi i lejeve të hyrjes dhe kartave të shërbimit

Të gjitha lejet e hyrjes dhe qëndrimi në zonë si dhe kartat e shërbimit regjistrohen në një regjistër të veçantë, i cili mbahet nga përfaqësuesi i Entit pranë Zonës së lirë. Në regjistër përmbledhen të gjitha të dhënat që përmbajnë këto dokumente.

VII. PËRFAQËSUESIT E ENTIT NË ZONË

Neni 26

Funksionet e përfaqësuesve të Entit në zonë.

Enti Kombëtar i Zonave të Lira emëron përfaqësuesit e tij në zonë për të kontrolluar dhe mbikëqyrur në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e zonës. Detyrat e përfaqësuesit të Entit në zonë janë si më poshtë:

- a. Të mbikëqyrë dhe të kontrollojë aktivitetin e zhvilluesit në zonë, në përputhje me kushtet e përcaktuar në licencën e tij.
- b. Të mbikëqyrë dhe të kontrollojë aktivitetin e përdoruesve në zonë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në licencat e tyre.
- c. Të lëshojë në bashkëpunim me zhvilluesin dhe përdoruesin të gjitha llojet e lejeve të hyrjes

dhe të qëndrimit në zonë.

d. Të informojë Entin për çdo gjë që ai e shikon të nevojshme lidhur me funksionimin e zonës.

VIII. FUNKSIONIMI I KËSHILLIT DREJTUES

Neni 27

Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues përbëhet nga shtatë anëtarë.
2. Zgjedhja e anëtarëve, emërimi i kryetarit, zëvendësimi i tyre dhe kompetencat e Këshillit Drejtues bëhen në bazë të dispozitave të ligjit nr. 8636, datë 6.7.2000 “Për Zonat e lira”.

Neni 28

Mbledhja e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues ka përgjegjësi për funksionimin e Entit. Ai e zhvillon veprimtarinë e tij nëpërmjet mbledhjeve të anëtarëve të tij. Mbledhjet mbahen kur marrin pjesë jo më pak se katër anëtarë të Këshillit Drejtues.
2. Këshilli Drejtues mbledhet sa herë është e nevojshme dhe jo më pak se një herë në tre muaj. Enti Kombëtar kryen funksionet e sekretarisë së Këshillit Drejtues. Të paktën dy anëtarë, kanë të drejtë t’i kërkojnë kryetarit mbledhjen e Këshillit Drejtues sa herë që e gjykojnë të nevojshme. Të gjithë anëtarët duhet të informohen me shkrim, jo më pak se 5 (pesë) ditë para mbledhjes, për problemet që do të diskutohen dhe t’u vihen në dispozicion materialet paraprake.
3. Mbledhja e Këshillit drejtohet nga kryetari dhe në mungesë së tij nga nënkryetari. Ky i fundit, zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Këshillit Drejtues, me propozim të kryetarit. Mbledhja mund të drejtohet nga një anëtar, kur ai është i autorizuar për një gjë të tillë nga personat e lartpërmendur në radhë hierarkike.

Neni 29

Marrja e vendimeve

1. Çdo anëtar i pranishëm në mbledhjen e Këshillit Drejtues ka të drejtën e një vote. Vendimet e Këshillit Drejtues merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Votimi mund të jetë i fshehtë ose i hapur, gjë që vendoset me shumicë votash nga vetë Këshilli që në fillim të mbledhjes. Kur numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.
2. Në mbledhjen e Këshillit Drejtues mbahet procesverbal. Ky procesverbal miratohet nga Këshilli Drejtues dhe nënshkruhet rregullisht nga të gjithë pjesëmarrësit jo më vonë se mbledhja pasardhëse. Të gjithë procesverbalet duhet të regjistrojnë vendimet përkatëse të mbledhjes dhe të ruhen. Vendimet e mbledhjes nënshkruhen nga kryetari, në mungesë (nga drejtuesi i mbledhjes) dhe drejtori ekzekutiv.
3. Në mbledhje merr pjesë edhe një specialist i caktuar i Entit që nuk ka të drejtë vote, por mban procesverbalin, harton vendimet, i firmos dhe i arkivon ato.
4. Në mbledhjen e Këshillit Drejtues mund të marrin pjesë sipas rastit edhe specialistë të Entit si dhe këshilltarë të jashtëm, të cilët nuk kanë të drejtë vote.

Neni 30

Shpërblimi i Këshillit Drejtues

1. Anëtarët e Këshillit Drejtues marrin shpërblim për çdo mbledhje të Këshillit ku ata marrin pjesë në masën 30%, dhe Kryetari i Këshillit Drejtues në masën 35% të pagës mujore të Drejtorit Ekzekutiv të Entit.
2. Në qoftë se një anëtar i Këshillit Drejtues nuk merr pjesë në tre mbledhje radhazi pa justifikuar mungesën, Këshilli shqyrton çështjen dhe merr masën përkatëse.

Neni 31
Dispozita të fundit

1. Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozimin e Këshillit Drejtues dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.
2. Ngarkohet Enti të hartojë udhëzimet përkatëse për zbatimin e kësaj rregulloreje.
3. I bashkëngjiten kësaj rregulloreje formëkërkesat nr.1, 2, 3, 4 si pjesë përbërëse të saj.



Address

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Ministria e Drejtësisë, kati III.z.4,6
Tel: ++355 42 36552

Fax: ++355 42 35651

Formëkërkesë

E shoqërisë

Që aplikon për licencë zhvilluesi në zonat e lira

Formëkërkesa për marrjen e licencës së zhvilluesit bazohet në ligjin nr. 8636, datë 6.7.2000 “Për Zonat e lira”.

Kjo formë-kërkesë është përcaktuar nga Enti Kombëtar i Zonave të Lira sipas pikës 1, nenit 3 të rregullores “Për Zonat e lira” datë _____ 2000, mbështetur në nenin 24.1 të ligjit “Për Zonat e lira”.

Formëkërkesa plotësohet nga ata persona fizikë ose juridikë që aplikojnë për licencë zhvilluesi.

Kërkesa duhet shoqëruar me nga:

- një kopje e statutit të shoqërisë, një kopje e vendimit të regjistrimit në gjykatë, një kopje e vendimit të përfaqësuesit ligjor; kodin tatimor dhe NIPT-in;
- një kopje e licencës së aktivitetit për vitin në vazhdim, bilanci e tri viteve të fundit kur ka aktivitet jashtë Zonës së lirë, në rastin kur kandidati zhvillues është shoqëri e re, zotëruesi i paketës kontrolluese duhet të paraqesë bilanci e tri viteve të fundit të veprimtarisë së tij;
- profilin tekniko-ekonomik të shoqërisë dhe CV-të e drejtuesve të saj;
- në rastin e truallit privat duhet të paraqesë dokumentet e pronësisë ose kontratën e qirasë për truallin ose pasurinë e paluajtshme që do të shpallet Zonë e lirë;
- biznes-planin e aktivitetit të shoqërisë si zhvillues i Zonës së lirë;
- projektin e plotë ndërtimor për infrastrukturën e brendshme dhe lidhjen e saj me infrastrukturën e jashtme;
- burimet e financimit të projektit dhe garancitë e paraqitura ndaj financuesit;
- letër rekomande nga një bankë me veprimtari në tregun ndërkombëtar, letrat e pjesëmarrjes e të interesit të lëshuar nga persona që mendojnë të investojnë në zonë;
- vërtetim në të cilin vërtetohet që shoqëria nuk është në procedura likuidimi dhe dëshmitë e penalitetit për drejtuesit kryesor të saj.

Dhe në një zarf të mbyllur dërgohet me postë rekomande ose dorazi në sektorin e procedurës pranë Entit Kombëtar të Zonave të Lira:

- formëkërkesa të plotësohet me makinë shkrimi ose me dorë duke përdorur gërma të mëdha;
- fletët e bashkëngjitura duhet të identifikohen si të tilla dhe të firmosen nga nënshkruesi i kësaj kërkesë.

FORMËKËRKESË NR.1

Të dhëna për shoqërinë që aplikon për licencë zhvilluesi

Emërtimi _____ Forma juridike _____

Adresa _____

Tel. _____ Fax. _____

Nr. i regj. Në Regjistrin tregtar _____ Data _____

Nr. i vendimit për administratorin _____ Data _____

Kodi tatimor _____ NIPT _____

Nr. i kontratës të sigurimeve shoqërore _____ Data _____

Banka (bankat) _____ Nr. i llogarisë _____

Të dhëna për përfaqësuesin (ose përfaqësuesit) ligjor

1. Emri _____ Mbiemri _____
 Nr. Pas./Let. _____ Vendi i lëshimit _____ Data _____

2. Emri _____ Mbiemri _____
 Nr. Pas./Let. _____ Vendi i lëshimit _____ Data _____

Llojet e aktiviteteve për të cilat kërkohet licenca:

Shënim

Në qoftë se vendi është i pamjaftueshëm, ju lutemi të bëni shtesat përkatëse në letër të bardhë. Kjo formë kërkesë shoqërohet me gjithë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në rregulloren e Zonave të lira.



Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
 Ministria e Drejtësisë, kati III.z.4,6
 Tel: ++355 42 36552
 Fax: ++355 42 35651

Address

Formë kërkesë

E shoqërisë

Që aplikon për licencë zhvilluesi në zonat e lira

Formë kërkesa për marrjen e licencës së Përdoruesit bazohet në ligjin nr. 8636, datë 6.7.2000 “Për Zonat e lira”.

Kjo formëkërkesë është përcaktuar nga Enti Kombëtar i Zonave të Lira sipas pikës 1, neni 11 i Rregullores “Për Zonat e lira” datë _____ 2000, mbështetur në nenin 24.2 të ligjit “Për Zonat e lira”.

Formëkërkesa plotësohet nga ata persona fizikë ose juridikë që aplikojnë për licencë përduruesi.

Kërkesa duhet shoqëruar nga:

- Akti i themelimit të shoqërisë, vendimi i gjykatës për regjistrimin si person juridik ose fizik, vendimi i emërimit të përfaqësuesit ligjor;
- Statuti i shoqërisë;
- Kodi tatimor dhe NIPT-i;
- Vërtetim nga organet tatimore që nuk kanë detyrime financiare ndaj shtetit ku ka pasur aktivitet jashtë zonës së lirë;
- Aktmarrëveshje me kusht pezullues me zhvilluesin për t’i vënë në dispozicion përdoruesit sipërfaqe dhe objekte jashtë zonës, ku kërkesa për licencim të miratohet;
- Numri i regjistrimit në organet e Sigurimeve Shoqërore Shtetërore;
- Biznesplani i aktivitetit brenda Zonës së lirë;
- Rekomandim nga një bankë brenda ose jashtë vendit.

Dhe në një zarf të mbyllur dërgohet me postë rekomande ose dorazi në sektorin e procedurës pranë Entit Kombëtar të Zonave të Lira.

-Formë kërkesa të plotësohet me makinë shkrimi ose me dorë duke përdorur germa të mëdha.

-Fletët e bashkëngjitura duhet të identifikohen si të tilla dhe të firmosen nga nënshkruesi i kësaj kërkesë.

FORMËKËRKESË NR. 2

Të dhëna për shoqërinë që aplikon për licencim të parë si përdorues

Emërtimi _____	Forma juridike _____
Adresa _____	
Tel. _____	Fax. _____

Nr. i regj. Në Rregjistrin Tregtar _____	Data _____
Nr. i vendimit për administratorin _____	Data _____

Kodi tatimor _____	NIPT _____
Nr. i kontratës të sigurimeve shoqërore _____	Data _____
Banka (bankat) _____	Nr. i llogarisë _____

Të dhëna për përfaqësuesin (ose përfaqësuesit) ligjor

1. Emri _____	Mbiemri _____
Nr. Pas./Let. _____	Vendi i lëshimit _____ Data _____
2. Emri _____	Mbiemri _____
Nr. Pas./Let. _____	Vendi i lëshimit _____ Data _____

Llojet e aktiviteteve për të cilat kërkohet licenca:

Shënim

Në qoftë se vendi është i pamjaftueshëm, ju lutemi të bëni shtesat përkatëse në letër të bardhë. Kjo formëkërkesë shoqërohet me gjithë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në rregulloren e Zonave të lira.

FORMËKËRKESË NR. 3

Të dhëna për shoqërinë që aplikon për rilicencim

Emërtimi _____ Forma juridike _____
Adresa _____
Tel. _____ Fax. _____

Nr.i regj. Në Regjistrin tregtar _____ Data _____
Nr.i vendimit për administratorin _____ Data _____

Kodi tatimor _____ NIPT _____
Nr.i kontratës të sigurimeve shoqërore _____ Data _____
Banka (bankat) _____ Nr.i llogarisë _____

Të dhëna për licencën ekzistuese

Nr.i licencës ekzistuese _____
Data e lëshimit _____ Data e skadimit _____

Shkaqet e rilicencimit

Ju lutemi përcaktoni në kuadrate elementet që keni ndryshuar nga ata të licencimit ekzistues dhe bashkëngjitni ndryshimet

1. Objekti i veprimtarisë ☐
2. Emërtimi ☐
3. Zgjatja e veprimtarisë ☐
4. Forma juridike ☐
5. Elemente të tjerë ☐

Llojet e aktiviteteve për të cilat kërkohet licenca

Shënim

Në qoftë se vendi është i pamjaftueshëm, ju lutemi të bëni shtesat përkatëse në letër të bardhë.

Kjo formë-kërkesë shoqërohet me gjithë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në rregulloren e Zonave të lira.

Tiranë më _____

FORMËKËRKESË NR. 4

Të dhëna për shoqërinë që aplikon për rinovim licence

Emërtimi _____	Forma juridike _____
Adresa _____	
Tel. _____	Fax. _____

Nr.i regj. Në Regjistrin tregtar _____	Data _____
Nr.i vendimit për administratorin _____	Data _____

Kodi tatimor _____	NIPT _____
Nr.i kontratës të sigurimeve shoqërore _____	Data _____
Banka (bankat) _____	Nr.i llogarisë _____
_____	_____

Të dhëna për licencën e skaduar

Nr.i licencës së skaduar _____	
Data e lëshimit _____	Data e skadimit _____

Llojet e aktiviteteve

Shënim

Në qoftë se vendi është i pamjaftueshëm, ju lutemi të bëni shtesat përkatëse në letër të bardhë. Kjo formëkërkesë shoqërohet me gjithë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në rregulloren e Zonave të lira.

KËRKESË

drejtuar

Entit kombëtar të Zonave të lira

Për licencim të ushtrimit të veprimtarisë në zonën e lirë

Në bazë të ligjit nr. 8636, datë 6.7.2000 shoqëria _____ kërkon licencimin për kryerjen e veprimtarisë ekonomike si _____ në Zonën e lirë të _____, duke plotësuar të gjitha dokumentet e nevojshme.

Deklaroj me vullnet të lirë se janë të vërteta të gjitha informacionet e dhëna në:

Formëkërkesën nr.1 ☐

Formëkërkesën nr.2 ☐

Formëkërkesën nr.3 ☐

Formëkërkesën nr.4 ☐

Emri

(nënshkrimi dhe vula)

Shënim:

Formë-kërkesat përkatëse të shoqërohen me dokumentacionin e përcaktuar në rregulloren e Zonave të lira.

Enti Kombëtar i Zonave të lira
Sektori i procedurës

DEKLARATË PRANIMI

Deklarojmë se kemi marrë në dorëzim nga shoqëria:

Emërtimi _____

Adresa _____

Tel. _____ Fax. _____

Dokumentet e nevojshëm për të filluar procedurat e licencimit për _____

Data e pranimit _____

Përgjegjësi i sektorit të procedurës

(nënshkrimi dhe vula)

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 18.2.2003
Doli nga shtypi më 19.2.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë